



KONTROLLI I LARTË I SHETIT KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 1236/13 Prot.

Tiranë, më, 27/04/2017

V E N D I M

Nr. 32, Datë 27/04/2017

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SARANDË "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare", të ushtruar në Bashkinë Sarandë për periudhën 01.07.2015 deri më 31.12.2016 dhe ish-Komunën Ksamil për periudhën 30.06.2014 deri më 30.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë nuk ka të përcaktuar misionin dhe vizionin e institucionit, si dhe nuk ka hartuar politika dhe strategji për zhvillimin e njësisë vendore

Rregullorja e funksionimit të brendshëm administrativ të bashkisë është hartuar në vitin 2008, e cila nuk është aktuale dhe nuk pasqyron ndryshimet ligjore dhe strukturore që kanë ndodhur si rezultat i reformës territoriale. Nuk ka rregullore të kodit etik dhe të arkivës.

Nuk janë implementuar kërkesat e nenit 8, 16, 22, 23, 24 të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi grupi për menaxhimin strategjik nuk ka funksionuar, nuk është hartuar regjistri i riskut, përshkrimet e punës, gjurma e auditimit për proceset kryesore të punës, mungojnë rregulla të shkruara për ruajtjen e aktiveve, për raportimin e stafit të titullari, llojin e deklaratave, shpeshësinë e tyre, si dhe nuk është analizuar funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, duke mos përcaktuar mangësitë që ka dh masat që duhen marrë.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për implementimin e kërkesave për një sistem të shëndosh të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke hartuar rregullore dhe procedura të qarta për të gjithë aktivitetin e përditshëm të institucionit, në mënyrë që secili punonjës të ketë të qartë detyrat funksionale. Ky sistem të monitorohet në vazhdimësi për funksionimin e tij.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e auditit të brendshëm në auditimet e planifikuara dhe të realizuara nuk është bazuar në vlerësimin e riskut, sepse nuk janë kryer auditime në fushat me risk, si prokurimet publike, kontratat e dhënies me qira të plazheve publike, asetet e tjera të institucionit, debitorët e taksave dhe tarifave vendore, etj. Funksionimi i saj formal ka bërë që gjetjet dhe rekomandimet janë të karakterit organizativ dhe disiplinor, jo të nivelit thelbësor, ku për vitin 2016 niveli i gjetjeve me karakter dëm ekonomik është në vlerën 200 mijë lekë.

2.1. Rekomandimi: Njësia e auditit të brendshëm në hartimin e planit vjetor dhe strategjik të parashikojë auditimin e fushave me risk, si prokurimet publike, rregullshmëria e veprimeve të kryera me bankë, kontratat e qirave etj., si në aktivitetin e veprimtarisë së Bashkisë dhe të njësive vartëse, duke i dhënë mbështetje titullarit të njësisë publike për arritjen e objektivave.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, u konstatua se janë paguar me vendim gjykate për largim të padrejtë të punonjësve, gjithsej për vlerën **17,036,282 lekë**, nga e cila: *likuiduar deri me datë 31.12.2016 vlera prej 13,907,568 lekë dhe mbetur për likuidim vlera prej 3,127,964 lekë.*

Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Sarandë nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën **17,036,282 lekë**, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj personave shkaktarë të gjendjes, si dhe të ndjekin e proceseve në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

3.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për ngritjen e Komisionit Disiplinorë dhe për çdo rast të largimit të punonjësve nga shërbimi civil ose zgjidhjen e kontratës së punës, të ndjekë dispozitat e VKM nr. 116, datë 05.03.2014 “Për statusin e nëpunësit dhe punonjësve aktual që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit 152/13, për nëpunësin civil” dhe ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Menjëherë e në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, u konstatua se janë paguar me vendim gjykate për konflikte midis Bashkisë Sarandë dhe subjekteve private, gjithsej për

vlerën **28,229,989 lekë**, nga e cila likuiduar deri me datë 31.12.2016 vlera prej 13,827,029 lekë dhe mbetur për likuidim vlera prej 14,403,710 lekë.

Për këto procese gjyqësore të humbura, Bashkia Sarandë nuk ka analizuar shkaqet e lindjes së tyre dhe marrë masa ndaj personave përgjegjës, veprim në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015”, pika 6.1 “Vendimet gjyqësore”.

Në 4 raste nuk janë ndjekur procedurat e ankimimit në Gjykatën e Lartë, ndërsa në 4 raste Bashkia Sarandë nuk ka marrë pjesë në proceset gjyqësore të zhvilluara, duke krijuar mundësi subjekteve private të shpallen fitues për mungesë pjesëmarrje nga Bashkisë Sarandë për vlerën **3,670,285 lekë**, veprim në kundërshtim me ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre” dhe nenet 126 deri në 306 -310 të “Kodit të Procedurës Civile”.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të analizojë të gjitha proceset gjyqësore të cilat kanë sjellë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën **28,229,989 lekë**, të kërkojë nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore ndaj personave shkaktarë të gjendjes, si dhe të ndjekin e proceseve në të gjitha shkallët e gjyqësorit.

Menjëherë e në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave për dalje jashtë përdorimit të materialeve/mallrave (asete) në ish-Komunën Ksamil, rezulton se nuk janë zbatuar procedurat e asgjësimit të materialeve/mallrave, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sek publik, Kapitulli IV-Sistemi i kontrollit të aktiveve, pikat 73-109, duke bërë që disa artikuj me vlerë **2,505,775 lekë** të mos i nënshtrohen procesit të rishitjes së tyre për realizimin e të ardhurave, si: elektropomë ujë, depozitë ujë, pyje.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për moszbatimin e procedurave ligjore në nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve/mallrave në ish-Komunën Ksamil me vlerë **2,505,775 lekë**, ndaj ish-anëtarëve të komisionit të asgjësimit.

Brenda datës 30/06/2017

6. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Sarandë dhe ish-Komunën Ksamil nuk janë zbatuar kërkesat e parashikuara në kontratën e lidhur për dhënie me qira të sipërfaqeve të plazheve, pasi janë lidhur kontrata pa u kryer pagesa e detyrimit për qiranë, duke evidentuar një borxh në vlerën **7,185,914 lekë**, nga e cila vlera prej 1,452,514 lekë nga 24 debitorë të ish Komunës Ksamil dhe vlera prej 5,733,400 lekë nga 23 debitorë të Bashkisë Sarandë.

Ndërsa në vitin 2016 kontratat janë lidhur pa u paraqitur plan biznesi për standardet për ruajtjen e bregdetit dhe sigurisë së pushuesve, buxheti për këtë qëllim, ekstrakti i regjistrimit të subjektit, vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore etj., veprime në kundërshtim me nenit 4, të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për arkëtimin e detyrimit në vlerën **7,185,914 lekë nga 47 subjekte** për sipërfaqen e plazheve të marrë me qira dhe në të ardhmen të mos realizoj lidhjen e kontratës me qiramarrësin pa u bërë më parë pagesa për detyrimet debitorë.

Brenda datës 30/06/2017

7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkisë Sarandë janë lejuar të punojnë “në të zezë” (pa u regjistruar në QKR, pa NIPT) **304 subjekte** në vitin 2015, **401 subjekte** në vitin 2016, ndërsa për ish Komunën Ksamil **38 subjekte** për periudhën 2014-2015.

Punësimi “në të zezë”ka sjellë mospagim të detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, veprim në kundërshtim me pikën 6 dhe 7, të paragrafit III të VKM nr. 77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, duke krijuar një të **ardhur të munguar për fondin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 16,917,758 lekë**, nga e cila: në Bashkinë Sarandë vlera prej 15,999,918 lekë dhe në ish-Komunën Ksamil vlera 917,840 lekë.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Tatimore Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për moslejimin e punësimit në të zezë në territorin e Bashkisë Sarandë.

Brenda datës 30/06/2017

8. Gjetje nga auditimi: Në **19 raste** në ish-Komunën Ksamil gjatë vitit 2014, janë lidhur kontrata për dhënien e sipërfaqeve të plazheve me qira me afate kohore të ndryshme, ku në 5 raste afati i dhënies me qira është 10 ditë, në 1 (një) rast 15 ditë dhe në 7 raste 30 ditë, veprime të cilat kanë shkaktuar të ardhura të munguara në **vlerën 1,023,090 lekë** në buxhetin e ish-Komunës Ksamil. Ndërsa në Bashkinë Sarandë kontratat për vitin 2015 janë lidhur pas datës 1 korrik 2015 dhe detyrimi për pagesë është llogaritur **50 ditë**, duke mos u shtrirë minimalisht as në harkun kohor të 60 ditëve për periudhën Korrik - Gusht.

Veprimet e mësipërme kanë shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën **1,459,680 lekë**, në kundërshtim me germën (ç) e pikës 3 e Kreu I, të VKM nr. 321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, i ndryshuar me VKM nr. 463 datë 20.05.2015.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Drejtorinë Juridike, të marrë masa që në lidhjen e kontratave për dhënien e sipërfaqeve me qira të plazheve, koha e fillimit dhe mbarimit të kontratës të llogaritet bazuar në legjislacionin në fuqi duke synuar maksimizimin e të ardhurave për institucionin nga kjo veprimtari.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi arkëtimin e debitorëve, u konstatua se nga Bashkia Sarandë nuk janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e kësaj bashkie me datë 31.12.2016 vlerën **146,614,158 lekë**, nga e cila vlera 131,817,728 lekë për 1152 subjekte private dhe vlera 14,796,430 lekë për 1108 abonent familjarë.

Drejtoria Ekonomike nuk ka kryer kontabilizimi e debitorëve, për faktin se nga Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë dhe ish-Zyra e Taksave Ksamil nuk janë dorëzuar listat e debitorëve me protokoll.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor, të ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreun II-Mbajtja e kontabilitetit dhe inventarizimi i aktiveve e detyrimeve, neni 6-Evidenca mbështetëse, pika 1 dhe 2, neni 7-Inventari i aktiveve dhe detyrimeve, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 ”Për MFK”.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e debitorëve në shumën **146,614,158 lekë**, nga e cila vlera 131,817,728 lekë për 1152 subjekte private dhe vlera 14,796,430 lekë për 1108 abonent familjarë, bazuar në nenin 70 pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nxirren njoftim vlerësimet tatimore për debitorët dhe të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikane të Shqipërisë".

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikane të Shqipërisë".

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore Republikane të Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, të llogariten në vazhdimësi kamat vonesa.

d-Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative të ndiqen procedurat për kallëzim penal.

e- Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të evidentojë dhe njoftojë familjarët për të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën/tarifën vendore (pastrimit, ndriçimit, banesave dhe gjelbërimit), në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".

f- Drejtoria Ekonomike të kontabilizojë detyrimin në vlerën **146,614,158 lekë**, nga e cila vlera 131,817,728 lekë për 1152 subjekte private dhe vlera 14,796,430 lekë për 1108 abonent familjarë, bazuar në nenin 70 pika 3-E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor dhe në bashkëpunim dhe me zyrën e taksave të administrojë listat e debitorëve.

Brenda datës 30/06/2017

10. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë nuk ka një strukturë përgjegjëse për administrimin e aseteve, mungesë e cila ka sjellë mos përdorimin dhe mos vënien në eficiencë të resurseve të NJQV, por dhe mos arkëtimin në kohë të ardhurave nga qiraja.

-Për asetet e kaluara me VKM në pronësi të Bashkisë Sarandë dhe Njesisë Administrative Ksamil është vepruar në kundërshtim me pikën 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", lidhur me krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve, si dhe pikën 31/d, pasi nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, të dhënat e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

-Për të gjitha asetet (pyjet e kullotat) e kaluara me VKM në pronësi apo përdorim të Bashkisë Sarandë dhe Njesisë Administrative Ksamil, nuk është kryer azhurnimi periodik i tyre, si dhe nuk është bërë procesverbali i dorëzimit nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, duke bërë që gjendja dokumentare e tyre të mos përputhet me realitetin sipas terrenit, ku një pjesë e tyre nuk ekzistojnë, janë me sipërfaqe të ndryshme nga sa kaluar me VKM, apo kanë kaluar në pronësi të subjekteve me anë të lejeve të legalizimit të lëshuara nga ALUIZNI, si dhe nuk është bërë regjistrimi i plotë i pasurive në ZVRPP, në kundërshtim me pikat 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011. Për pronat e zëna forcërisht, nuk janë marrë masat për lirimin e tyre nga zaptuesit dhe përdoruesit e paligjshëm të tyre.

10.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë, me qëllim krijimin e të ardhurave dhe administrim sa më efektiv të resurseve të njesisë vendore, të paraqes për miratim në Këshillin Bashkiak, strukturën e Administrimit të Pronave, e cila duhet të ketë për qëllim dhe objektiv të punës:

-Mbajtjen e regjistrit kontabël të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim, si dhe regjistër të veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit, kontrata e qirasë, afati i vlefshmërisë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore, arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik, etj.

-Përditësimin e të gjitha pasurive të paluajtshme, regjistrimin në ZVRPP të pasurive të kaluara në pronësi, propozimit për lidhje dhe hartimit të kontratave të qirasë, monitorimit, arkëtimin të detyrimeve, mirëmbajtjes, dhe çdo problematikë që lidhet me administrimin e tyre.

-Azurnimin e përditësimit e të gjitha aseteve në pronësi e përdorim (troje, objekte, pyjeve e kullotave), pasurive të zëna forcërisht dhe propozimin e masave për lirimin e tyre dhe vënin në funksion e përdorim të komunitetit, sipas destinacionit të përcaktuar në VKM apo VKB.

-Hartimin e inventarit real/aktual të pasurive dhe miratimin e listës përfundimtare të pronave.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha praktikatat e audituara mbi lëshimin e lejeve të përdorimit në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (DPKT), është konstatuar se nuk ka Vërtetim të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Sarandë mbi konfirmimin e situacionit përfundimtar të punimeve, por vetëm vërtetim se subjekti nuk ka detyrime tatimore të papaguara, duke mos pasqyruar vlerën përfundimtare e objektit.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, për objektet që aplikojnë për pajisje me leje përdorimi, tu kërkojë subjekteve që krahas situacionit përfundimtar të paraqesin dhe atë të konfirmuar apo t'i drejtohet zyrtarisht DRT Sarandë, që të konfirmojnë zyrtarisht vlerën përfundimtare të punimeve, sipas faturave tatimore dhe situacionit përfundimtar të punimeve dhe në rast të konstatimit të vlerave tepër, të përllogarisë diferencat për tu paguar nga secili subjekt.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Për **30 objekte** me leje ndërtimi, janë lëshuar certifikata përdorimi, pa u aplikuar neni 40 dhe 52 “Shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve” dhe “Përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit” i ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, duke u krijuar të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën prej **15,000,000 lekë**.

-Për **8 objekte** ndërtimi, është lëshuar leje për shtyrje të afatit apo rifreskim pa u aplikuar neni 40 dhe 52 i ligjit nr. 107/2014, duke u krijuar të ardhura të munguara në buxhet për vlerën **4,000,000 lekë**.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore:

-Arkëtimin e shumës prej **15,000,000 lekë**, të objekteve të cilat edhe pse janë pajisur me certifikatë përdorimi, kanë rezultuar se kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit apo edhe kanë vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

-Arkëtimin e shumës prej **4,000,000 lekë**, duke kryer inspektimi në terren për secilit objekt dhe mbajtja e akteve përkatëse. E njëjta procedurë të realizohet për të gjitha objektet të cilat kanë shkelur afatet e lejeve të ndërtimit dhe objektet të cilat kanë përfunduar në afat, duke vënë në përdorim objektin pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Brenda datës 30/07/2017

13. Gjetje nga auditimi: Më datë 01.07.2003, është lidhur kontrata “Për dhënie me qira të Lokalit Bar Restorant Butrinti dhe Lulishte”, me palë qiramarrëse M.D. dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 148 m² të llojit objekt dhe 542 m² truall i lirë (lulishte) dhe qëllim përdorimi “Përdorimi për aktivitet tregtar”, me afat përdorimi për 20 vjet, me çmim objekti 148 m² x 1 Dollar/m²/muaj ose 148 USA Dollar dhe çmim lulishte për sipërfaqen 542 m² x 80 lekë/m²/muaj ose 3,613 lekë/muaj.

Subjekti nuk ka paguar detyrimet për periudhën e viteve 2005 - 2007 dhe 2014 e vazhdim, në vlerën prej **10656 USA Dollar** për objektin dhe 260,160 lekë për truallin/lulishte, si dhe nga bashkia nuk është bërë përditësimi i çmimit për objektet dhe truallin sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014 të ndryshuar, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave, ajo Ekonomike dhe Juridike, të marrin masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **10656 USA Dollar** për objektin dhe **260,160 lekë** për truallin/lulishte.

Në rast mos likuidimi të detyrimeve, të marrë masat për prishjen e kontratës dhe lirim të sendit, duke e vënë atë në posedim të institucionit, si dhe duke e publikuar në faqen e Buletinit të Prokurimeve Publike, me qëllim dhënien e tij në përdorim subjekteve private të interesuara.

Brenda datës 30/07/2017

14. Gjetje nga auditimi: Nga përpunimi i të dhënave të listës së debitorëve midis dy periudhave (fund viti 2015 dhe fillim viti 2016), u konstatua se disa subjekte debitor në fund të vitit 2015, në çelje të vitit 2016 janë pasqyruar më pak në vlerë ose nuk janë pasqyruar fare për vlerën **29,552,898 lekë**, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar me ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Lokale”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

14.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të evidentojë, saktësoj dhe rikontabilizojë për vlerën e detyrimit të pa kontabilizuar në vitin 2016 për vlerën 29,552,898.

Brenda datës 30/06/2017

15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kryer në Bashkinë Sarandë dhe ish-Komunën Ksamil (sot Njësi Administrative Ksamil), mbi me zbatimin e rekomandimeve të KLSH, rezultoi se:

-Për Bashkinë Sarandë, me shkresën nr. 452/10, datë 30.09.2014 janë rekomanduar **22** masa shpërblim dëmi me vlerë **24,501,698 lekë**, nga të cilat janë zbatuar plotësisht **4** masa me vlerë **1,953,875 lekë**, janë në proces zbatimi **10** masa me vlerë **7,474,941 lekë**, ndërsa nuk janë zbatuar **12** masa me vlerë **7,270,236 lekë**.

-Për ish-Komunën Ksamil, me shkresën nr. 592/6, datë 24.09.2014 janë rekomanduar **25** masa organizative me vlerë 9,021.042 lekë, nga të cilat janë zbatuar 13 masa me vlerë 5,668,410 lekë, janë në proces zbatimi 6 masa me vlerë 3,352,542 lekë dhe nuk janë zbatuar **6** masa, ndërsa nga **9** masa shpërblim dëmi me vlerë **77,530,414 lekë**, nuk është zbatuar **asnjë masë**, duke lënë pa zbatuar vlerën **77,530,414 lekë**.

15.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Sarandë, të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara të KLSH^{së}, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **92,275,591 lekë**, nga e cila: Bashkia Sarandë në vlerën 14745177 lekë dhe ish-Komuna Ksamil në vlerën 77,530,414 lekë.

Deri me datë 30/06/2017

B/1. SHPENZIME NË FUSHËN E PROKURIMEVE, ME IMPAKT NEGATIV NË BUXHET:

Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluara në Bashkinë Sarandë, u konstatuan se **7** procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomik janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST të miratuara nga Autoritetit Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprim këto *me impakt negativ në buxhet* për vlerën **494,573,545**

lekë, duke favorizuar operatorët ekonomik në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit dhe shpallur fitues me kriterë të paplota, konkretisht:

1. Në tenderin me objekt **“Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Cukës”**, me fond limit në vlerën 124,905,956 lekë, zhvilluar me datë 30.11.2015, në të cilën është shpallur fitues OE [REDACTED] me vlerë kontrate prej **120,145,961 lekë**.

2. Në tenderin me objekt **“EKO Kampus Saranda”**, me fond limit në vlerën 276,292,007 lekë, zhvilluar në vitin 2015, në të cilën është shpallur fitues BOE [REDACTED] & [REDACTED] & [REDACTED] shpk me vlerë kontrate prej **275,481,211 lekë**.

3. Në tenderin me objekt **“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”** me fond limit 88,036,649 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, ka paraqitur ofertë të vetme OE [REDACTED] shpk me vlerë **85,432,057 lekë pa TVSH**, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO.

4. Në tenderin me objekt **“Blerje kontejnerë për mbeturina urbane”** me fond limit 4,000,000 lekë zhvilluar në vitin 2016, kanë marrë pjesë dy OE ku është kualifikuar OE [REDACTED] me ofertë më të lartë për vlerën **3,949,150 lekë**.

5- Në tenderin me objekt **“Rikonstruksion Rruga Nr. 17. Pjesa Komune – Degëzim rruga Nr. 17/1 (faza e parë)”**, me fond limit në vlerën 3,333,331 lekë, zhvilluar me datë 17.5.2014, në të cilën është shpallur fitues BOE [REDACTED] shpk me vlerë kontrate prej **2,525,500 lekë**.

6. Në tenderin me objekt **“Rrethimi i varrezave Ksamil”**, me fond limit në vlerën 2,485,913 lekë, zhvilluar me datë 17.6.2014, në të cilën është shpallur fitues OE [REDACTED] shpk me vlerë kontrate prej **1,777,778 lekë**.

7. Në tenderin me objekt **“Rikonstruksion i rrugës nr. 17 (nga Komuna deri te kryqëzimi i rrugës 17/1) (vazhdimi faza e dyte asfaltimi)”**, me fond limit në vlerën 6,637,068 lekë, zhvilluar me datë 20.4.2015, në të cilën është shpallur fitues BOE [REDACTED] shpk me vlerë kontrate prej **5,534,888 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative të pamatshme.

Në vijimësi

B/2. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 129,408,602 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave sipas funksioneve në ish-Komunën Ksamil, u konstatua se klasifikimi dhe kategorizimi i pagës të përgjegjës të zyrës (klasa III, kategoria III-a/1) është bërë në kundërshtim me VKM nr. 598, datë 27.04.2009, i ndryshuar me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të

organeve të qeverisjes vendore", pasi klasa III-a/1 duhet klasifikuar në klasën III-b "Përgjegjës sektori; Specialist i nivelit të lartë; Inspektor", ku sipas VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02/07/2008 të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja 2 me një diferencë për vlerën **126,714 lekë**.

1.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 126,714 lekë**, nga punonjësit e ish-punonjësit:

-vlera **5,139 lekë** për F.M. me funksion ish-Përgjegjës i Zyrës Urbanistike;

-vlera **30,835 lekë** për V.V. me funksion sekretare në Njësia Administrative Ksamil;

-vlera **30,870 lekë** për M.K. me funksion specialist në Zyrën e Administrimit të tokës Njësia Administrative Ksamil;

-vlera **42,744 lekë** për A.B. me funksion specialist në Ndërmarrjen e Shërbimeve;

-vlera **17,126 lekë** për A.B. me funksion specialist në Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territori.

Brenda datës 30/06/2017

2. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e bordero pagesave të muajit Janar 2015, u konstatua se është paguar për diferencë page në vlerën **79,204 lekë** A.B. me funksion ish-Përgj/Zyrës së INUV, nga e cila: diferencë muaj Tetor 2014 në vlerën 39,602 lekë dhe muaj Nëntor 2014 në vlerën 39,602 lekë, pagesa këto të kryera pa asnjë dokumentacion ligjorë për të argumentuar arsyen e kryerjes së këtyre diferencave, veprime në kundërshtim me pika 35/b pika 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

2.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 79,204 lekë** nga punonjësi A.B. me funksion specialist në Ndërmarrjen e Shërbimeve Sarandë.

Brenda datës 30/06/2017

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Sarandë dhe ish-Komunën Ksamil, janë kryer pagesa për shpërblimin e këshilltarëve të këshillit Bashkiak dhe të Komunës për çdo muaj mbi bazën e listprezencave të pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga sekretari këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listprezencat e dorëzuara, ndaj të cilëve është paguar shpërblimi padrejtësisht në shumën **732,827 lekë**, nga e cila për këshilltarët e Bashkisë Sarandë në vlerën 439,472 lekë dhe për këshilltarët e ish-Komunës Ksamil për vlerën 293,355 lekë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", pika 1 e nenit 51.

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 732,827 lekë**, respektivisht për:

-vlera **439,472 për këshilltarët e Bashkisë Sarandë:** A.G. për vlerën **19,976 lekë**, F.V. për vlerën **9,988 lekë**, F.X. për vlerën **29,964 lekë**, H.M. për vlerën **9,988 lekë**, H.C. për vlerën **19,976 lekë**, K.S. për vlerën **9,988 lekë**, M.Xh. për vlerën **19,976 lekë**, M.L. për vlerën **9,988 lekë**, P.G. për vlerën **9,988 lekë**, P.A. për vlerën **9,988 lekë**, Sh.A. për vlerën **9,988 lekë**, F.X. për vlerën **9,988 lekë**, A.H. për vlerën **9,988 lekë**, A.B. për vlerën **19,976 lekë**, L.H. për vlerën **9,988 lekë**, V.G. për vlerën **9,988 lekë**, M.Xh. për vlerën **19,976 lekë**, M.N. për vlerën **9,988 lekë**, Dh.L. për vlerën **9,988 lekë**, H.C. për vlerën **29,964 lekë**, A.I. për vlerën **19,976**

lekë, M.L. për vlerën **9,988 lekë**, A.V. për vlerën **29,964 lekë**, A.G. për vlerën **9,988 lekë**, Sh.A. për vlerën **29,964 lekë**, P.G. për vlerën **29,964 lekë** dhe K.S. për vlerën **19,976 lekë**.

-vlera 293,355 lekë për këshilltarët e ish-Komunës Ksamil: Gj.I. për vlerën **14,310 lekë**, A.A. për vlerën **7,155 lekë**, Q.Q. për vlerën **7,155 lekë**, Sh.V. për vlerën **7,155 lekë**, M.D. për vlerën **7,155 lekë**, A.A. për vlerën **21,465 lekë**, B.H. për vlerën **14,310 lekë**, E.H. për vlerën **14,310 lekë**, F.O. për vlerën **14,310 lekë**, F.F. për vlerën **21,465 lekë**, Gj.I. për vlerën **14,310 lekë**, H.I. për vlerën **14,310 lekë**, L.Z. për vlerën **21,465 lekë**, M.D. për vlerën **14,310 lekë**, P.A. për vlerën **14,310 lekë**, Q.Q. për vlerën **14,310 lekë**, R.D. për vlerën **14,310 lekë**, S.A. për vlerën **21,465 lekë**, Sh.V. për vlerën **21,465 lekë**, V.M. për vlerën **14,310 lekë**.

Brenda datës 30/06/2017

4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, u konstatua se në zbatimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, veprimet e kryera dhe dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, nenin 11, neni 23/4; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 60-61; me UKM nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu i pikën 3.1 dhe 8.3; të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3 me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54; Urdhrin MF nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3; me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 98, në shkëlqje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Sarandë në shumën **1,466,955 lekë**, respektivisht praktikatat:

-urdhër shpenzimi nr. 379, datë 03.07.2015 për vlerën **100,000 lekë** me objekt “*Shërbime të tjera, rikonstruksion i nivelimit të zoda së notit Esat Mamica*”;

-urdhër shpenzimi nr. 400, datë 13.07.2015 për vlerën **180,000 lekë** me objekt “*Studim Projektim për rikonstruksionin me shtesë kati dhe shtesë anësore i shkollës Shefqet Sulejmani, Gjashtë*”;

-urdhër shpenzimi nr. 442, datë 05.08.2015 me vlerën **616,920 lekë** me objekt “*Pastrim mbetje urbane Vollder dhe në rrugën Metoq-Cukë*”;

-urdhër shpenzimi nr. 708, datë 18.12.2015 me vlerën **426,535 lekë** me objekt “*Pastrim i mbetjeve të ngurta*”;

-urdhër shpenzimi nr. 764, datë 01.12.2016 për vlerën **29,000 lekë** me objekt “*Riparim pjesë makine (mbrapakolpi, stop, punime)*”

-urdhër shpenzimin nr. 228, datë s’ka me vlerë 114,500 lekë, janë kryer shpenzime me objekt “*Blerje pjesë këmbimi për automjete*”. Në dokumentacionin që shoqëron këtë urdhër shpenzim, konstatohet se nuk ka asnjë procedurë të zhvillimit të prokurimit me procedurë blerje me vlerë të vogël për likuidimin e lekëve në adresë të subjektit “Pëllumb Sejdi”.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 1,466,955 lekë**, ndaj punonjësve:

-vera prej 233,553 lekë për F.K. me funksion Kryetar Bashkie;

-vera prej 472,523 lekë për T.S. me funksion Drejtor Ekonomik;

-vera prej 405,606 lekë për P.H. me funksion Drejtor Shërbimesh;

-vera prej 345,606 lekë për E.GJ. me funksion Drejtor Juridik;

-vera prej 9,667 lekë për SH.A. me funksion Përgjegjës i Policisë Bashkiake.

Brenda datës 30/06/2017

5. Gjetje nga auditimi: Me urdhër shpenzimin nr. 60, datë s’ka është likuiduar vlera prej **200,000 lekë** me objekt “*Shpenzime për fondacionin [REDACTED]*” (OJF). Nga dokumentacioni

konstatohet se nuk ka asnjë marrëveshje bashkëfinansim të lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë dhe Fondacionit "Linda", për realizim projektesh, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar neni 11- "*Funksionet e veta*" pika II/c "shërbimi social dhe administrimi i institucioneve si çerdhet, azilet, shtëpitë e fëmijëve, etj."; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" Kreu II. 3 "Buxheti vendor" pika 114/ nënpika (c), për financimin shpenzimeve me karakter social.

Kryerja e shpenzimit mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës të parregullt dhe me mangësi, është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, date 8.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" neni 4/26,12 me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik" pika 35,36, 38, 52,54 dhe 60, **me pasojë dëmin ekonomik në vlerën 200,000 lekë.**

5.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 200,000 lekë**, ndaj punonjësve:

-vera prej **100,000 lekë** ndaj F.K. me funksion Kryetar Bashkie;

-vera prej **100,000 lekë** ndaj T.S. me funksion Drejtor Ekonomik.

Brenda datës 30/06/2017

6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se në **8 raste me vlerë 431,650 lekë**, janë kryer shpenzime për Koktejlle festash me rastin e vitit të ri dhe 7-8 marsit. Fondi i përdorur për përballimin e këtyre shpenzimeve nuk është nga fondi i veçantë, por është përdorur artikulli 602 (shpenzime operative).

Këto shpenzime janë në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 "Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999, duke sjellë një efekt financiar negativ me **dëm në shumën 421,650 lekë.**

6.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 421,650 lekë**, ndaj punonjësve:

-vera prej **140,550 lekë** për F.K. me funksion Kryetar Bashkie;

-vera prej **140,550 lekë** për T.S. me funksion Drejtor Ekonomik;

-vera prej **140,550 lekë** për J.M. me funksion Nënkryetar i Bashkisë Sarandë për çështjet ekonomike.

Brenda datës 30/06/2017

7. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se nga Drejtoria Ekonomike nuk është mbajtur tatimi në burim në zbatim të ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar neni 28 dhe 33 pika (f), për shpenzimet e kryera me objekt "*Projektartistik pa kufi*", duke evidentuar mungesë të ardhurash me **dëm për vlerën 45,000 lekë.**

Gjithashtu Drejtoria Ekonomike nuk duhej të kishte lidhur kontratë dhe kryer transaksione me subjekte të palicensuara, ku minimalisht duhet të kishte aplikuar detyrimin për tatimin në burim.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 45,000 lekë, për A.N.** përfaqësues i projekt artistik "Art pa kufi", dhe për asnjë rast të mos lidhë kontrata ose kryer transaksione financiare me subjekte të palicensuar.

Brenda datës 30/06/2017

8. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se janë kryer shpenzime për karta telefoni në vlerën 180,000 lekë, veprime këto në kundërshtim me pikat 2,

3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11, të VKM nr. 864, datë 23.04.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik dhe publik”, pasi nuk plotëson asnjë specifikim të përcaktuar në të këtij vendimi, në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për **vlerën 284,000 lekë**.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 284,000 lekë**, *respektivisht punonjësve:*

- vlera **6,000 lekë** për F.K. me funksion Kryetar Bashkie;
- vlera **236,000 lekë** për E.K. me detyrë Specialiste pranë Kryetarit;
- vlera **42,000 lekë** për N.M. me detyrë ish-Drejtoreshë Kabineti.

Brenda datës 30/06/2017

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, konstatohet se në **5 raste** janë kryer shpenzime për dieta për punonjësit e Bashkisë Sarandë, në kundërshtim me ligjin nr. nr. 9920, datë 19.05.2005 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar neni 54-*Kuponi* tatimorë pika 2 dhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 13 germa (a), duke evidentuar një vlerë prej **31,255 lekë**, me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 31,255 lekë**, ndaj punonjësve:

- vlera **10,225 lekë** për Th.N. me detyrë specialist kabineti;
- vlera **18,000 lekë** për punonjësit S.P.
- vlera **3,000 lekë** për punonjësit T.H.

Brenda datës 30/06/2017

10. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi menaxhimin e karburantit në Bashkinë Sarandë, konstatohet se nga personat përgjegjës, dokumentacioni që shoqëron përdorimin e tij nuk është në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35/b pika 36, pasi punonjësit që kanë tërhequr karburantin nuk e kanë justifikuar me fletudhëtim dhe se nga personat përgjegjës të Bashkisë Sarandë nuk është kërkuar sqarim mbi këtë problem, ku nga mos dokumentimi i përdorimit është evidentuar mos justifikimi i sasisë prej **5633.05 litra me vlerë 942,845 lekë**, veprime financiar me efekt negative me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 942,845 lekë**, ndaj *personave përgjegjës:*

- vlera **232,180 lekë** për A.K. me funksion Kryeinspektor i IMTV;
- vlera **265,668 lekë** për B.A. me funksion ish-Drejtor i Taksave;
- vlera **9,874 lekë** për E.P. me funksion specialist në Drejtorinë e Shërbimeve;
- vlera **212,938 lekë** për F.S. me funksion ish-Administrator i Njesisë Ksamil;
- vlera **6,748 lekë** për G.S. me funksion Sekretar i Përgjithshëm;
- vlera **16,457 lekë** për K.K. me funksion Nënkyetar Bashkie;
- vlera **32,940 lekë** për L.C. me funksion specialist në Drejtorinë e Shërbimeve;
- vlera **41,143 lekë** për R.S. me funksion ish-Drejtor i Nd/Shërbimeve;
- vlera **124,897 lekë** për P.H. me funksion Drejtor i Shërbimeve;

Brenda datës 30/06/2017

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi menaxhimin e karburantit në ish-Komunën Ksamil, konstatohet se nga personat përgjegjës, dokumentacioni që e shoqëron nuk është në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35/b pika 36, pasi punonjësit që kanë tërhequr karburantin nuk e kanë justifikuar me dokumentacion ligjorë (fletudhëtime), për të cilën nga personat përgjegjës

të ish-Komunës Ksamil nuk është kërkuar sqarim mbi këtë problem. Nga mos dokumentimi i përdorimit të tij është evidentuar mos justifikimi i sasisë prej **1979 litra me vlerë 342,853 lekë**, veprime financiar me efekt negative me dëm në buxhetin e ish-Komunës Ksamil.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 342,853 lekë**, ndaj *personave përgjegjës:*

-vlera **266,091 lekë** ndaj B.A. me funksion ish-Kryetar Komunës Ksamil;

-vlera **76,762 lekë** ndaj K.V. me funksion ish-shofer i administratës së Komunës Ksamil.

Brenda datës 30/06/2017

12. Gjetje nga auditimi: Në auditimi e likuidimeve me banke dhe nga dokumentacion bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, u konstatua se në **6 raste me vlerë 4,832,245 lekë** nuk janë zbatuar kamatëvonesat për mos përfundimin në afat të punimeve, parashikuar kjo në kontratat e punimeve dhe dokumentet standarde, veprim në kundërshtim me nenit 6, germa (e), të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 4,832,245 lekë**, ndaj subjekteve:

-vlera **2,837,232 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **758,237 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **557,760 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **166,553 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **253,878 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **258,585 lekë** për subjektin [REDAKTUAR].

Brenda datës 30/06/2017

13. Gjetje nga auditimi: Në auditimi e likuidimeve me banke dhe dokumentacion bashkëlidhur urdhër shpenzimeve, u konstatua se në ish-Komunën Ksamil në **3 raste me vlerë 2,949,657 lekë**, nuk janë zbatuar kamatëvonesat për mos përfundimin në afat të punimeve, parashikuar kjo në kontratat e punimeve dhe dokumentet standarde, në kundërshtim me nenit 6, germa e, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 2,949,657 lekë**, ndaj subjekteve:

-vlera **1,476,425 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **381,849 lekë** për subjektin [REDAKTUAR];

-vlera **1,092,383 lekë** për subjektin [REDAKTUAR].

Brenda datës 30/06/2017

14. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit mbi likuidimin e kontratave të punimeve, u konstatua se në fatura tatimore e fundit (*bashkëshoqërues e situacionit përfundimtar të punimeve*), është paraqitur jashtë afateve ligjore të përfundimit të punimeve në objekti të përcaktuara në kontratë, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 7928 datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, neni 13-“*Momenti i furnizimit*”, i ndryshuar me nenin 99, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014, pasi janë paraqitur tej afatit kohor të dorëzimit të punës së kryer në një kohë që furnizimi quhet i kryer në momentin kur

është e detyrueshme të lëshohet fatura, duke mos llogaritur sanksionet për përfundimin në afat të punimeve në vlerën **1,210,497 lekë**, dëm ekonomik në buxhet, respektivisht në objektet:

-“*Rikonstruksioni i 6 banesave te komunitetit Rom dhe Egjiptian*”, për faturën tatimore faturë nr. 78, datë 07.12.2015 në vlerën 662,599 lekë, në mos llogaritje kamatëvonesë në vlerën **108,666 lekë** në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR];

-“*Mirëmbajtje dhe pastrim i gropës septike lagjja nr. 3 Ksamil*”, për faturat tatimore nr. 107, datë 02.12.2014, në shumën 1,092,000 lekë dhe nr. 124, datë 22.12.2014, në shumën 681,300 lekë, në mos llogaritje kamatëvonesë në vlerën **83,998 lekë** në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR];

-“*Rrethimi i varrezave Ksamil*”, për faturat tatimore nr. 70, datë 17.11.2014, në shumën 1,706,739 lekë dhe nr. 70, datë 17.11.2014, në shumën 78,201 lekë, në mos llogaritje kamatëvonesë në vlerën **635,438 lekë** në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR];

-“*Blerje tabela për adresat ne Ksamil*”, për faturën nr. 80, datë 14.09.2014 në shumën 2,166,960 lekë, në mos llogaritje kamatëvonesë në vlerën **381,395 lekë** në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR];

14.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e vlerës **1,210,497 lekë**, respektivisht në objektet:

-**vlera 108,666 lekë** kamat vonesë në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR], për objektin “*Rikonstruksioni i 6 banesave te komunitetit Rom dhe Egjiptian*”, me faturë nr. 78, datë 07.12.2015 në vlerën 662,599 lekë;

-**vlera 83,998 lekë** kamat vonesë në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR], për objektin “*Mirëmbajtje dhe pastrim i gropës septike lagjja nr. 3 Ksamil*”, me faturat tatimore nr. 107, datë 02.12.2014, në shumën 1,092,000 lekë dhe nr. 124, datë 22.12.2014, në shumën 681,300 lekë;

-**vlera 635,438 lekë** kamat vonesë në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR], për objektin “*Rrethimi i varrezave Ksamil*”, me faturat tatimore nr. 70, datë 17.11.2014, në shumën 1,706,739 lekë dhe nr. 70, datë 17.11.2014, në shumën 78,201 lekë;

-**vlera 381,395 lekë** kamat vonesë në ngarkim të subjektit [REDAKTUAR], për objektin “*Blerje tabela për adresat ne Ksamil*”, me faturën nr. 80, datë 14.09.2014 në shumën 2,166,960 lekë.

Brenda datës 30/06/2017

15. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit në rezervuarin e qytetit*” Sarandë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **26,787,180 lekë pa t.v.sh** si pasojë e mos ndryshimit në situacion të zërit të punimeve sipas zërit të kryer në fakt si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **214,338 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 21, datë 23.12.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE , neni 27 *Dëmshpërblimet për vonesa*, me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar, pika 9 si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “*Për mbikëqyrjen dhe kolauditimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu II, Pika 3, pika 8.1 dhe 8.3.

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **26,787,180 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDAKTUAR] sh.p.k në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 21, datë 23.12.2015 me objekt “*Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit në rezervuarin e qytetit*” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e mos ndryshimit të zërit të punimeve në situacion sipas zërit të kryer në fakt.

15.2. Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **214,338 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED] sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 21, datë 23.12.2015 me objekt “Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit në rezervuarin e qytetit” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e punimeve.

Brenda datës 30/06/2017

16. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza, zona nga Hotel Butrinti deri tek Kanali i Çukës” Sarandë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **2,107,100 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **16,777,988 lekë pa TVSh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 22, datë 23.12.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE, shpk neni 27 Dëmshpërblimet për vonesa si dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve neni 3, 4 dhe neni 7.

16.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,107,100 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik [REDACTED] shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 22, datë 23.12.2015 me objekt “Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza, zona nga Hotel Butrinti deri tek Kanali i Çukës” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

17.2. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **16,777,988 lekë pa TVSh** nga operatori ekonomik [REDACTED] shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 22, datë 23.12.2015 me objekt “Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza, zona nga Hotel Butrinti deri tek Kanali i Çukës” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e punimeve.

Brenda datës 30/06/2017

17. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim asfaltim rruga nr. 5, Loti II dhe Loti III” Sarandë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **31,014,500 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 14, datë 11.06.2015 të lidhur mes ish – Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE [REDACTED] shpk, si dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve datë 11.06.2015 neni 3, 4 dhe neni 7.

17.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **31,014,500 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik [REDACTED] shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 14, datë 11.06.2015 me objekt “Ndërtim asfaltim rruga nr. 5, Loti II dhe Loti III” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Brenda datës 30/06/2017

18. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Konturimi dhe shtrimi i rrugëve të brendshme të fshatit Gjashtë Ofiçina e Naftës, Metoq” Sarandë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të

zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **618,500 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 9, datë 14.04.2015 të lidhur mes ish – Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe BOE ██████ shpk, si dhe kontratën e mbikëqyrjes së punimeve datë 14.04.2015 neni 3, 4 dhe neni 7.

18.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **618,500 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik ██████ shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 14 prot., datë 11.06.2015 me objekt “*Konturimi dhe shtrimi i rrugëve të brendshme të fshatit Gjashtë Ofiçina e Naftës, Metoq*” Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Brenda datës 30/06/2017

19. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumenteve të bankës në njësinë vartëse të Bashkisë Sarandë, Klubin e Sportit, u konstatua se janë paguar dieta për 16 lojtarë dhe personeli me 1,400 lekë/dietë dhe 1,000 lekë/nata, ndërsa trajneri me 2800 lekë/dietë dhe 1000 lekë/nata, për dy ndeshje gjithsej në vlerën 84,400 lekë, kjo sipas vendimit nr. 7, date 24.01.2013, të Këshillit Mbikëqyrës ku përcaktohet për ekipin e pare dieta/ditë është 2,000 lekë shpenzime ushqimi dhe 1,000 lekë/nata, ndërsa për moshat U-17 dhe U-19 shpenzimi ushqimi është dieta/ditë është 700 lekë dhe 1000 lekë/nata, duke evidentuar një vlerë prej **12,600 lekë**.

19.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Klubin e Sportit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 12,600 lekë**, respektivisht:

- vlera **5,600 lekë** për S.B. me funksion trajner i ekipit U-17;
- vlera **5,600 lekë** për A.F. me funksion trajner i ekipit U-19;
- vlera **1,400 lekë** për Dh.M. me funksion trajner i ekipit U-19SH.

Brenda datës 30/06/2017

20. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2014 ish Komuna Ksamil ka lidhur 49 kontrata me objekt “Dhënie me qira e sipërfaqeve të plazheve”. Në 30 kontrata detyrimi për pagesë i qirasë ka filluar më vonë se data e lidhjes së kontratës, fenomen që është përsëritur edhe në Bashkinë Sarandë për vitin 2016 në 59 kontrata.

Për këtë arsye, në afatin kohor nga data e lidhjes së kontratës deri në fillimin e pagesës së detyrimit, qiramarrësit kanë zhvilluar aktivitete në pronën shtetërore pa kryer pagesë qiraje, kjo për **90 kontrata me vlerë 4,599,000 lekë, e ardhur dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Sarandë, nga e cila: vlera 1,023,000 lekë i përket 33 qiramarrësve të ish Komunës Ksamil dhe vlera 3,576,000 lekë 57 qiramarrësve të Bashkisë Sarandë.**

Gjithashtu në ish Komunën Ksamil kontratat në vitin 2014 janë lidhur me afat mbi 5 vjet, por në to nuk është përcaktuar numri i ditëve për pagesë për vitin pasardhës 2015, për këtë vit janë nxjerrë njoftim vlerësime nga zyra e taksave, në të cilat janë bërë diferencime midis qiramarrësve për numrin e ditëve që janë ngarkuar me detyrim qiraje.

Nga 49 kontrata gjithsej për vitin 2015, për 13 kontrata në njoftim vlerësim është llogaritur se qiramarrësi do të paguaj qira për 60 ditë, për një kontratë njoftim vlerësim është llogaritur se qiramarrësi do të paguaj qira për 90 ditë dhe për 33 kontrata detyrim është llogaritur më pak se 60 ditë.

Duke konsideruar si afat optimal të detyrimit për pagesë muajin korrik dhe gusht (60 ditë), numri i ditëve të lëna jashtë këtij afati për 35 raste ka sjell një detyrim të pa llogaritur në vlerën **2,315,300 lekë, e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e ish-Komunës Ksamil.

20.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa saktësimin, kontabilizimi dhe arkëtimin e vlerës **6,914,300 lekë**, sipas pasqyrës Aneks nr. 11, 12 & 16, bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore.

Brenda datës 30/06/2017

21. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2015 dhe 2016 nga Bashkia Sarandë sipërfaqja e plazheve të dhëna me qira është llogaritur e pasaktë, pasi është më e vogël nga sa duhej, për arsye se:

a- Nga sipërfaqja e qiramarrësit është zbritur sipërfaqja e emërtuar “hapësira të përbashkëta”, e cila nuk është e mbështetur në bazë ligjore;

b- Sipërfaqja “hapësirë publike 20%”, e cila i është zbritur qiramarrësit nga detyrimi është llogaritur gabim (*është llogaritur më e madhe, duke bërë që sipërfaqja e taksueshme të zvogëlohet*).

Të dy elementët e mësipërm kanë zvogëluar në mënyrë artificiale sipërfaqja e taksueshme dhe detyrimin e pagesës për qiramarrësin.

Në total për vitin 2015 për 45 qiramarrës, sipërfaqja e lënë jashtë detyrimit për pagesë është 3,174 m², në vlerën 2,380,650 lekë, për vitin 2016 për 85 qiramarrës, kjo sipërfaqe është 5,614 m², në vlerën 5,613,800 lekë, gjithsej për dy vitet vlera e detyrimit të qirasë që nuk ju është llogaritur qiramarrësve është **7,994,450 lekë, dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Sarandë**, veprime në kundërshtim me pikën 1, paragrafi IV, dhe shtojcën B-3 të VKM nr. 321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, i ndryshuar.

21.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për kontabilizimi dhe arkëtimin e vlerës **7,994,450 lekë**, sipas pasqyrës Aneks nr. 13 & 14 bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore. Me qëllim që të informohen qytetarët të publikohet lista e plazheve që administron Bashkia Sarandë për dhënie me qira.

Brenda datës 30/06/2017

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit në teren të plazheve të dhëna më qira, u konstatua se Bashkia Sarandë nuk ka evidentuar dhe ngarkuar me detyrim subjektin [REDAKTUAR] për sipërfaqen në administrim prej 3000 m² tokë truall (pontil).

Bazuar në VKM nr. 54, datë 02.05.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, pika 2, paragrafi III, tarifa e qirasë mujore për truallin e lirë është 100 lekë/m². Mos evidentimi i kësaj sipërfaqeje tokë truall nga Drejtoria e Taksave Vendore dhe Drejtoria e Shërbimeve për efekt të llogaritjes së detyrimeve dhe mos lidhja e një kontrate sipas VKM së mësipërme, ka sjellë mungesë të ardhurash me dëm në buxhetin e Bashkie Sarandë për vlerën **7,200,000 lekë** në ngarkim të subjektit (*3,600,000 për secilin prej viteve 2015-2016*).

Gjithashtu sipërfaqja e plazhit nga 460 m² që duhej të taksohej është taksuar 420 m² ose 40 m² më pak për vitin 2015 dhe 2016, duke mos llogaritur vlerën **70,000 lekë, dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

22.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Drejtorinë Juridik në Bashkinë Sarandë, të marrë masa për evidentimin e sipërfaqes truall të shfrytëzuar nga subjekti [REDAKTUAR] duke lidhur kontratë ligjore (para noterit publik), në zbatim të VKM nr. 54, datë 02.05.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, pika 2, paragrafi III, si dhe përcaktuar dhe arkëtuar detyrimet për

qiranë në vlerën **7,270,000 lekë**.

Brenda datës 30/06/2017

23. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë nuk ka evidentuar saktë sipërfaqen e ndërtesës për subjektin kompleksi [REDACTED] shpk.

Për vitin 2015 dhe 2016, bazuar në shkresën nr. 6957/1 prot, datë 28.10.2015 të ZVRPP, taksa mbi ndërtesën është llogaritur mbi sipërfaqen 1,923 m² në vlerën 576,900 lekë/ vit, shkresë e cila sqaron se të dhënat i referohen dokumentacionit që administron ZVRPP dhe jo sipërfaqeve faktike në terren. Nga Bashkia nuk janë marrë masa për evidentimin e sipërfaqes faktike në teren.

Nga informacioni i marrë nga Bashkia sipas planvendosjes së objektit, të dhënave për numrin e kateve dhe sipërfaqen e tyre, konstatohet se sipërfaqja e ndërtesës për kompleksin “Balili-Co” shpk është 6180 m². Sipërfaqja e pataksuar për secilin vit 2015 dhe 2016 është 4257 m². Taksa e ndërtesës për vitin 2015 dhe 2016 është 300 lekë/m²/vit dhe bazuar mbi këto të dhëna vlera e pallogaritur për taksën e ndërtesës për vitin 2015 dhe 2016 është **2,554,200 lekë**, e ardhur me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

23.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa saktësimin, kontabilizimi dhe arkëtimin e vlerës **2,554,200 lekë** nga subjekti [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore.

Brenda datës 30/06/2017

24. Gjetje nga auditimi: Në preventiv e tenderit me objekt “*Shërbimi i pastrimit të qytetit*” të zhvilluar gjatë vitit 2016, është parashikuar zëri largim i mbetjeve solide, në kundërshtim me nenin 5, të ligjit 8904 datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave“, në të cilin nuk përfshihet një zë i tillë. Në situacionin që operatori fitues i ka paraqitur Bashkisë Sarandë, ky zë ka vlerën **513,040 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

24.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **513,040 lekë**, ndaj personave përgjegjës:

-vlera **256,520 lekë** për P.H. me funksion Drejtor i Shërbimeve;

-vlera **256,520 lekë** për E.C. me funksion ish-specialist në Drejtorinë e Shërbimeve.

Brenda datës 30/06/2017

25. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2015 nuk është llogaritur taksë reklame për dy sipërfaqe reklamimi në pronësi të kompanisë [REDACTED], përkatësisht për sipërfaqen 29 m² me vlerë 243,000 lekë dhe 12 m² me vlerë 162,000 lekë, në total 405,000 lekë. Për vitin 2016 në dy raste taksa e tabelës është llogaritur më pak në vlerën 94,050 lekë për subjektin Vasiliqi Bezhani dhe në vlerë 15,750 lekë për subjektin Antoneta Maksakuli, duke shkaktuar **mungesë të ardhurash me dëm në buxhetin e Bashkisë për vlerën totale 514,800 lekë**.

25.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa saktësimin, kontabilizimi dhe arkëtimin e vlerës **514,800 lekë** nga subjektet:

-vlera **405,000 lekë** për subjektin [REDACTED];

-vlera **94,050 lekë** për subjektin [REDACTED];

-vlera **15,750 lekë** për subjekti [REDACTED].

Brenda datës 30/06/2017

26. Gjetje nga auditimi: Njësia e Shërbimeve Publike në varësi të Bashkisë Sarandë, në muajin dhjetor 2016 është zhvilluar me procedurën e emergjencës prokurimi me objekt “*Prerje e pemëve të rrezikshme si dhe sistemim i degëve të shqyera nga koha e keqe*” në vlerën **200,000 lekë**. Nuk justifikohet kryerja e këtij procesi pune me prokurim publik sepse kjo njësi ka në strukturë punonjës dhe mjete (motosharra, vinç, makinë me kosh etj.), me të

cilët duhet të realizojë punë të kësaj natyre. Për këtë arsye vlera **200,000 lekë, dëm ekonomik.**

26.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **200,000 lekë** nga punonjësi i Ndërmarrjes së Shërbimeve **J.B.**

Brenda datës 30/06/2017

27. Gjetje nga auditimi Në tenderin me objekt "Investime për rikonstruksione në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës" me fond limit 1,570,833 lekë zhvilluar në vitin 2016 është shpallur fitues operatori ekonomik [REDAKTUAR] shpk me vlerë 1,318,830 lekë dhe është s'kualifikuar operatori ekonomik [REDAKTUAR] shpk me vlerë 892,550 lekë, për arsye se nuk plotëson kriterin e përvojave të mëparshme të ngjashme.

Nga auditimi konstatohet se nuk qëndron pretendimi i KVO, pasi nga OE është paraqitur kontratë për punë të ngjashme me objekt "Rikonstruksion i shkollës Janjar, Komuna Markatë", me vlerë 10,734,121 lekë, në të cilën ka zëra pune të ngjashëm me ato të kontratës që prokurohet (si bërje dyer, dritare). Konkretisht OE ka paraqitur amendamentin nr.1, datë 04.04.2013, në nenin nr.1 të së cilës citohet se "Afati kohor për përfundimin e kontratës shtyhet me 205 ditë". Gjithashtu ka paraqitur procesverbalin e përfundimit të punimeve, akt-kolaudimin dhe situacionin nr.4 dhe përfundimtar të punimeve të cilët mbajnë datën 22.10.2013.

Për këto arsye KVO duhet të shpallte fitues OE [REDAKTUAR] shpk me vlerë të OE 892,550 lekë dhe jo OE [REDAKTUAR] shpk me vlerë të OE 1,318,830 lekë. Diferenca prej **426,280 lekë** (1,318,830-892,550), **dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

27.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **426,280 lekë, ndaj personave përgjegjës:**

- vlera **142,094 lekë** për P.H. me funksion Drejtor i Shërbimeve;
- vlera **142,094 lekë** për T.S. me funksion Drejtoreshë Ekonomike;
- vlera **142,094 lekë** për E.Gj. me funksion Drejtor Ekonomik.

Brenda datës 30/06/2017

28. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Sarandë nuk është llogaritur saktë taksa mbi ndërtesën duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën **2,727,750 lekë**, si më poshtë:

- 13 subjekte** me aktivitet hoteleri, për sipërfaqen totale 9,037 m², vlerën 2,491,950 lekë, viti 2015;
- për subjektet person fizik I.Q. në vlerën 76,200 lekë, A.H. në vlerën 124,200 lekë, për vitin 2015 dhe 2016;
- për subjektin N.S. në vlerën 27,000 lekë, për vitin 2016
- për subjektin A.D. në vlerën 8,400 lekë, për vitin 2016.

28.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike, të marrë masa saktësimin, kontabilizimi dhe arkëtimin e vlerës **2,727,750 lekë, respektivisht:**

- vlera **76,200 lekë** për subjektin I.Q.;
- vlera **124,200 lekë** për subjektin A.H.;
- vlera **27,000 lekë** për subjektin N.S.;
- vlera **8,400 lekë** për subjektin A.D.;
- vlera **2,491,950 lekë për 13 subjekte** sipas pasqyrës aneks nr. 20, bashkëlidhur Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30/06/2017

29. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Sarandë, nga 56 kontrata për dhënie me qira të pasurive të paluajtshme të llojit truall dhe ndërtesë, 33 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet nga qiraja në vlerën prej **2,756,648 lekë**, shumë e cila përbën të ardhura të munguar për buxhetin.

Bashkia nuk ka kërkuar apo marrë masat për arkëtimin e detyrimit si dhe nuk ka aplikuar kushtin penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, duke shkaktuar mungesë të ardhurash me dëm ekonomik në vlerën prej **637,533 lekë**.

29.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore, por dhe strukturat e tjera mbështetëse, të marrin masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale, për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e të ardhurave të munguara prej **2,756,648 lekë** dhe vlerës prej **637,533 lekë**, krijuar nga mos përlogaritja e penaliteteve.

Brenda datës 30/06/2017

30. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka lidhur kontratë datë 01.05.2011 “Për dhënie me qira të objektit Pontili i ri”, me palë qiramarrëse B.B. dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Lokal Shërbimi”, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, është konstatuar se sipërfaqja në përdorim të subjektit, me sipërfaqen që ai realisht disponon është mbi 500 m², ku gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar.

Mos llogaritja e sipërfaqes të konstatuar dhe rekomanduar për tu kontraktuar, përbën moszbatim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014, të ndryshuar **dhe ka sjellë dhe pasoja me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë e cila llogaritet 900,000 lekë/viti**.

30.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë të merren masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerën prej **1,161,000 lekë**, krijuar nga mos llogaritja dhe mos përfshirja në kontratë e një pjesë të pasurisë.

- Drejtoria Juridike të hartojë kontratën apo të bëhet shtesë në kontratën ekzistuese, ku të përfshihet e gjithë sipërfaqja e pronës, në përputhje me të gjitha kriteret e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Brenda datës 30/06/2017

31. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka lejuar që në hyrje të shëtitorës të bregut subjekti A.F. të marrë në përdorim duke realizuar dhe ngritjen e një objekti për Bar-Restaurant. Bashkia Sarandë nuk ka vepruar për lirimin e territorit të zaptuar dhe prishjen e objektit. Për sa kohë objekti është funksional duhej aplikuar tarifë/qira për përdorimin e autorizuar të rrugëve dhe pjesëve të saj si dhe mjediseve të tjera publike, për sipërfaqen prej rreth 150 m² me çmimin prej 100 lekë/m²/muaj për 12 muaj në vlerën prej 180,000 lekë, tarifa dhe procedura në referim të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 ndryshuar me, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016. Mos mbulimi i territorit dhe lejimi i subjektit të përdorim ambientet publike, pa kundërshpërblim, ka sjellë pasoja me **dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 270,000 lekë (18 muaj)**.

31.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e shumës prej **270,000 lekë**, krijuar nga mos kërkitimi i vlerës së qirasë..

- Drejtoria Juridike në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të hartojë kontratë qiraje për aq kohë sa bashkia vlerëson se objekti dhe shërbimi nuk pengon përdorimin e pronës publike, veprime në përputhje me të gjitha kriteret e VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” e ndryshuar.

Brenda datës 30/06/2017

32. Gjetje nga auditimi: Bashkia Sarandë ka lejuar që në 4 raste vendstrehime apo vendstrehime të nëndheshme, të lihen në përdorim të subjekteve private, pa një kontratë qiraje, në kundërshtim me VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013.

Të 4 vendstrehimet që përdoren nga subjektet private, për interesa të tyre, pa kontrata qiraje, pra në mënyrë të jashtëligjshme, në kushtet kur me hyrjen në fuqi të VKM nr. 1001, datë 13.11.2013, vlera e qirasë për $1/m^2$, për sipërfaqen prej rreth $1180 m^2 \times 100 \text{ lekë}/m^2 \times 12$ muaj = 1,416,000 lekë për vitin 2016 dhe 708,000 lekë për vitin 2015 kanë sjellë për pasojë të ardhura të munguara me pasojë **krijimin e dëmit ekonomik** për të dy vitet në vlerën **prej 2,124,000 lekë**.

32.1 Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,124,000 lekë**, krijuar nga mos kërkitimi i vlerës së qirasë.

- Drejtoria Juridike në bashkëpunim me strukturat përkatëse, të hartoj kontratë qiraje për aq kohë sa bashkia vlerëson se objektet duhen apo mund të lihen në përdorim të subjekteve private, veprime në përputhje me të gjitha kriteret e VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Brenda datës 30/06/2017

33. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë, u konstatua se nga Bashkia Sarandë me urdhër shpenzimit nr. 58, datë 16.02.2016 është paguar subjekti M.C. me licencë nr. Vp. 0127/1, datë 13.06.2008 në vlerën **376,800 lekë** me objekt “Shpenzim për vlerësim aseteve”, sipas faturës thjeshtë tatimore nr. 37, datë 23.11.2015.

Bashkia Sarandë përfaqësuar nga Kryetari ka lidhur akt-marrëveshje datë 15.09.2015 dhe M.Ç. për kryerjen e pagesave mbi vlerësimin e pasurisë.

Sipas dokumentacionit të audituar mbi shpronësimin e pasurive për interes publik (trajtuar në akt verifikimit nr. 8, datë 02.03.2017), u konstatua se objektet dhe trualli i shpronësuar nuk kishin nevojë për marrjen e ekspertëve vlerësuar për vlerësim, kjo pasi referuar shkresës nr. 4970, datë 29.09.2015, e Komisionit të Posaçëm të Shpronësimeve pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban për plotësim dokumentacioni dhe për vlerësimin e banesave me çmimin mesatar të marrë nga ZVRPP Sarandë për tre muajt e fundit, duke bërë që pagesa e kryer për vlerësim pasurie të jetë e kundërligjshme dhe në dëm të buxhetit të Bashkisë Sarandë për vlerën 376,800 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 9/4, neni 12/3; me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35, 36, 37, 38, 42, 43 dhe 44, 52, 54.

33.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 376,800 lekë** ndaj subjektit M.C.

Brenda datës 30/06/2017

34. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikualifikimi i Shëtitores ekzistuese ndriçimi”, Bashkia Sarandë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,555,555 lekë pa tvsh**, si pasojë e përfshirjes së tvsh – së pajisjeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 13 prot, datë 04.05.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe OE, me VKM nr. 514, datë

15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 8 dhe 9 si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, pika 8.1 dhe 8.3 si dhe me UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa “c”, paragrafi i fundit.

34.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masat duke kryer të gjitha veprimet administrativo-procedurale për të kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,555,555 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik ██████████ shpk në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 13 prot, datë 04.05.2015 me objekt “Rikualifikimi i Shëtitores ekzistuese ndriçimi” Sarandë.

Brenda datës 30/06/2017

C. MOS PËRDORIM ME EFEKTIVITET DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e veprimeve me bankë të Bashkisë Sarandë, u konstatua se nga ana e Titullarit të institucionit (Kryetari i Bashkisë), është lidhur me shumë se një kontratë shtesë për vlerën 20% e kontratës fillestare **dhe pa asnjë procedurë prokurimi**, veprime këto në kundërshtim me shkronjën (a, b) e pikës 5, të nenit 33, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar; me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 7 pika 4 dhe nenin 36 pika 3, duke krijuar një efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë nga mos zbatimi i procedurave të prokurimit të fondeve për **vlerën 7,080,095 lekë**, respektivisht:

a-Kontrata nr. s’ka, datë 12.03.2016 ndërmjet Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga Kryetari dhe subjektit ne vijim ██████████ për një periudhë 70 ditore nga data 12.03.2016 deri me datë 18.05.2016 dhe vlerë kontrate prej **599,655 lekë**, me objekti ruajtjen e objekteve Bashkia Sarandë dhe Stadiumi.

b- Kontrata nr. 16/2, datë 24.05.2016 ndërmjet Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga ish-Kryetari dhe subjektit që ishte ne vijim ██████████ për një periudhë 78 ditore nga data 13.03.2016 deri me datë 24.05.2016 dhe vlerë kontrate prej **4,804,702 lekë pa TVSh**, me objekti pastrimi i qytetit të Sarandës.

c- Kontrata nr. 16/2, datë s’ka ndërmjet Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga Kryetari dhe subjektit që ishte ne vijim ██████████ për një periudhë 78 ditore nga data 13.03.2016 deri me datë 24.05.2016 dhe vlerë kontrate prej **1,675,738 lekë**, me objekti pastrimi i qytetit të Njësisë Administrative Ksamil.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Sarandë nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa dhe të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për lidhjen e kontratave shtesë të shërbimit të ruajtjes së objekteve të Bashkisë Sarandë, Stadiumit dhe shërbimit të pastrimit të qytetit Bashkia Sarandë dhe të Njësisë Administrative Ksamil, me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **7,080,095 lekë**, që të eliminohen të tilla praktika, ndërkohë që përgjegjësia e cilësuar nga KLSH të ndiqet në të gjitha hallkat, lidhur me përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike.

Menjëherë

D. MASA DISPLINORE:

D/1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 gjerat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, **të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 9 punonjësit e mëposhtëm:**

a-“Largim nga shërbimi civil”, sipas pikës “c” e nenit 58.

1. T.S. me funksion Drejtoreshë Ekonomie dhe në pozicionin e anëtarit të KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos zbatimin e procedurave të blerjeve me vlera të vogla, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, nenin 11, neni 23/4; me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe neni 60-61, në shkelje të disiplinës financiare në buxhetin e Bashkisë Sarandë në shumën **1,784,105 lekë.**

-Mos mbajtjen dhe derdhjen në buxhet të tatimi në burim në zbatim të ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar neni 28 dhe 33 pika (f), për shpenzimet e kryera me objekt “*Projektartistik pa kufi*”, duke evidentuar mungesë të ardhurash **për vlerën 45,000 lekë.**

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”.

2. E.Gj. me funksion Drejtor Juridik dhe në funksionin e Kryetarit të KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për parregullsi në lidhjen e kontratës, pasi elementi “*sipërfaqe e taksueshme*” për plazhet e dhëna më qira nga Bashkia Sarandë për 88 kontrata në vitin 2016 është vendosur më i vogël nga sipërfaqja faktike, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **5,613,800 lekë.**

- Në cilësinë e anëtarit të grupit të punës “Për marrjen e masave për administrimin e plazhit përgjatë sezonit turistik 2016”, në kundërshtim me nenin 4, të VKM 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, pasi janë lidhur kontrata me qiramarrës të cilët nuk kanë paraqitur dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të VKM së mësipërme.

-Mos ndjekjen e proceseve gjyqësore të zhvilluara, duke krijuar mundësi subjekteve private të shpallen fitues për mungesë pjesëmarrje nga Bashkia Sarandë për vlerën **3,670,285 lekë.**

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”.

-Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. s’ka, datë 01.05.2011, “*Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri*”, me objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “*Lokal Shërbimi*”, me çmim prej 140,000 lekë.

-Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 02.06.2015, “*Për dhënien me qira të truallit të lirë në lagjen nr. 1 Sarandë*”, me objekt kontrate sipërfaqen prej 100 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “*Përdorimi për aktivitet tregtar me konstruksion të lehtë dhe lehtësisht të cmontueshëm*”, me çmim prej 120,000 lekë.

-Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 01.07.2003, “*Për dhënien me qira të Lokalit Bar Restorant Butrinti dhe Lulishte*”, me objekt kontrate sipërfaqen prej 148 m² të llojit objekt dhe 542 m² truall i lirë (lulishte) dhe qëllim përdorimi “*Përdorimi për aktivitet tregtar*”.

b - "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", parashikuar në nenin 58 germa "c".

1. M.M. me funksion specialist i njësisë së auditit të brendshëm.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mos dhënie mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë, duke mos u bazuar në vlerësimin objektiv të riskut për përgatitjen e planeve strategjike dhe vjetore për auditimin e brendshëm, në kundërshtim me nenin nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

2. M.D. me detyrë specialiste finance, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Kryerjen e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla, jo në format elektronik por me oferta (formulari 5), ku edhe ne këtë rast nga subjektet pjesëmarrës nuk janë depozituar ofertat e paraqitura, por ato janë të evidentuara vetëm në procesverbalin e hartuar nga komisioni, veprimet këto në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin rregullave të prokurimit publik" neni 40 dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla dhe nenin 6, germa e, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", veprime të cilat çojnë në mos përdorim me efektivitet të fondeve publike me vlerë **2,142,828 lekë**.

3. T.H. me funksion specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Llogaritje të gabuar të sipërfaqeve të taksueshme në hartat shoqëruese të kontratave të plazheve të dhëna me qira nga Bashkia Sarandë për 38 qiramarrës në vitin 2015 dhe 88 qiramarrës për vitin 2016, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **7,994,450 lekë**.

-Nuk është kryer detyra e evidentimit dhe marrjes së informacionit për zhvillimet në territorin nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", neni 80 "Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren", pika 1 dhe 2.

4. H.K. me funksion Drejtor i Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme".

-Nuk është kryer detyra e evidentimit dhe marrjes së informacionit për zhvillimet në territorin nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", neni 80 "Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren", pika 1 dhe 2.

-Për 30 objekte me leje ndërtimi, nuk ka gjetur zbatim ligji nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", neni 40 dhe 52, "shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve" dhe "përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit", dënohen me gjobë deri në 500,000 lekë, duke bërë që Bashkisë Sarandë ti jenë krijuar të ardhura të munguara në vlerën maksimale prej 15,000,000 lekë).

5. V.T. me funksion specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme".

-Nuk është kryer detyra e evidentimit dhe marrjes së informacionit për zhvillimet në territorin nën administrim nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritetet e tjera të planifikimit, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit", neni 80 "Vëzhgimi i Zhvillimeve në Terren", pika 1 dhe 2.

-Për 30 objekte me leje ndërtimi, nuk ka gjetur zbatim ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 40 dhe 52, “shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve” dhe “përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”, dënohen me gjobë deri në 500,000 lekë, duke bërë që Bashkisë Sarandë ti jenë krijuar të ardhura të munguara në vlerën maksimale prej 15,000,000 lekë).

6. z. S.I. dhe

7. z. R.M. me funksion specialist të inspektimit në terren në Drejtorinë e Taksave.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk kanë raportuar sipërfaqen prej 3000 m² tokë truall (pontil), pranë kompleksit në administrim të subjektit [REDACTED], e cila është lehtësisht e evidentuese, duke shmangur ngarkimin me detyrim të kësaj sipërfaqeje për vitin 2015 dhe 2016 **me pasojë dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë në vlerën **7,200,000 lekë**.

-Nuk kanë evidentuar saktë, për efekt taksimi, sipërfaqja e ndërtesën për kompleksin e subjektit [REDACTED], me pasojë **dëm ekonomik në vlerën 2,554,200 lekë**.

D/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 9, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave, **për 13 punonjësit e mëposhtëm:**

a-“Zgjidhjen e Kontratës së Punës”, germa “d” e nenit 9, të kontratës individuale:

1. z. J.M. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë dhe në cilësinë e Drejtorit të Taksave Vendore prej datës 15.12.2016.

Për shkeljet e mëposhtëm:

-Në lidhjen e kontratave për dhënien me qira të plazheve për vitin 2015 dhe 2016.

-Për llogaritje jo të saktë të sipërfaqeve të plazheve të dhëna me qira për 45 kontrata në vitin 2015 dhe 88 kontrata për vitin 2016, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **7,994,450 lekë**.

-Në **59 kontrata** qiraje nuk është llogaritur detyrimi për kohëzgjatjen e kontratës, duke shkaktuar një **dëm ekonomik në vlerën 3,576,000 lekë**.

-Në **45 kontrata** të lidhura në vitin 2015, ka përcaktuar si detyrimin pagese afatin 50 ditë, duke mos përfshirë të gjithë periudhën e sezonit të plazhit, në kundërshtim me VKM nr. 436, datë 20.05.2015, duke krijuar **të ardhura të munguara vlerën 1,459,680 lekë**.

-Nuk janë zbatuar plotësisht kërkesat e VKM nr. 529, datë 08.6.2011, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kreu II “Procedurat e Dhënies me Qira ose Enfiteozë të Pasurisë Shtetërore”.

-Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. *ska*, datë 02.06.2015, “Për dhënien me qira të truallit të lirë në lagjen nr. 1 Sarandë”, me objekt kontrate sipërfaqen prej 100 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Përdorimi për aktivitet tregtar me konstruksion të lehtë dhe lehtësisht të çmontueshëm”, me çmim prej 120,000 lekë.

b- “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës”, germa “b” e nenit 9, të kontratës individuale.

1. A.B. me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për llogaritje jo të saktë të sipërfaqeve të plazheve të dhëna me qira për 45 qiramarrës në vitin 2015 me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e njësisë vendore në vlerën **2,380,650 lekë**.

-Për 8 objekte me leje ndërtimi, nuk ka gjetur zbatim ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 40 dhe 52, “shkelja e afatit të fillimit apo përfundimit të punimeve” dhe “përdorimi i objektit pa lëshimin e certifikatës së përdorimit”, dënohen me gjobë deri në 500,000 lekë, *duke bërë që Bashkisë Sarandë ti jenë krijuar të ardhura të munguara në vlerën prej 4,000,000 lekë (8 leje x 500,000 lekë)*.

2. E.H. me detyrë specialist inspektimi në terren në Drejtorinë e Taksave.

Për shkeljet e mëposhtme:

Nuk ka raportuar sipërfaqen prej 3000 m² tokë truall (pontil), pranë kompleksit në administrim të subjektit “Balili-Co”, e cila është lehtësisht e evidentuese, duke shmangur ngarkimin me detyrim të kësaj sipërfaqeje për vitin 2015 dhe 2016 me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën 7,200,000 lekë.

3. M.K. me funksion ish-Përgjegjës i Zyrës së ATM dhe në cilësinë e anëtarit të NJP, aktualisht inspektor i tokës në zyrën ATM Njësia Administrative Ksamil.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Mos zbatim të procedurave të asgjësimit të materialeve, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sek publik, kap IV-sistemi i kontrollit të aktiveve, pika 73-106, ligji nr. 8562, datë 31.07.2000 “Organizimi dhe funksionimin e qeveris vendore”, neni 32”.

-Vendosjen e kriterëve kualifikues të procedurave të prokurimit në kundërshtim me Kreu III-“Dokumentet e tenderit”, pika 3-“Informacione të veçanta”, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik”, konstatuar kjo procedurat e prokurimit të vitit 2014.

4. A.Gj. me detyrë specialiste e vlerësimit dhe regjistrimit të taksave.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk ka marrë masa për regjistrimin e saktë, për efekt taksimi, të sipërfaqes së ndërtesën për kompleksin e subjektit “Balili-Co” shpk - Santa Quaranta me NIPT K36603503U, pasi ka bërë regjistrimin mbi bazën e një dokumenti i cili e thekson se nuk pasqyron sipërfaqen reale në teren, me pasojë **dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë në vlerën **2,554,200 lekë**.

-Për mos llogaritje të saktë të taksës së ndërtesës dhe tabelës me vlerë **147,200 lekë, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë**.

5. E.V. me detyrë inspektor i zyrës së taksave në njësinë administrative Ksamil.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për vitin 2014 nuk ka evidentuar subjektet me aktivitet turizëm familjar në ish-Komunën Ksamil. Nuk ka marrë masa shtrënguese për arkëtimin e 43 debitorëve gjatë viti 2014 në vlerën **2,244,028** dhe 398 debitorëve në vlerën **12,074,490** gjatë vitin 2015. Nuk ka bërë dorëzimin e listës të debitorëve me protokoll në arshivë dhe në finance për vitin 2014 dhe 2015.

6. G.S. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm Bashkisë Sarandë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Nuk ka marrë masa për zbatimin e urdhrin nr. 100 të Kryetarit të Bashkisë “Për ngritjen e grupit të punës si dhe miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme të

organizimit dhe funksionimit të brendshëm të grupit të punës për monitorimin e plazheve dhe problematikave të sezonit turistik”, pasi nuk janë përcaktua rregulla për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të grupit të punës për monitorimin e plazheve dhe problematikave, si dhe nuk janë bërë raporte periodike të titullari për plazhet e dhëna me qira gjatë sezonit turistik.

c-“Vërejtje” germa “a” e nenit 9, të kontratës individuale:

1. V.V. me funksion ish-Përgjegjëse e zyrës Personelit, aktualisht sekretare në Njësinë Administrative Ksamil.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Klasifikimi dhe kategorizimi i përgjegjësit të zyrës (klasa III, kategoria III-a/1), në kundërshtim me VKM nr. 598, datë 27.4.2009 i ndryshuar me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 1619, datë 2.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, lidhja 2.

- Mangësitë e konstatuara në dosjeve të personelit, në kundërshtim me VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrimit të personelit”, aneksi nr. 1 dhe 2.

2. S.M. me detyrë specialiste finance, në cilësinë e anëtarit të komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Kryerjen e procedurave të prokurimeve me vlera të vogla, jo në format elektronik por me oferta (formulari 5), veprimet në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe Udhëzimin e APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla dhe nenit 6, germa e, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, të ndryshuar dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave (UMF) nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu III, “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, “Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara”, veprime të cilat çojnë në mos përdorim me efektivitet të fondeve publike me vlerë **2,142,828 lekë**.

3. A.H. me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e supervizimit e shërbimit të pastrimit.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk janë mbajtur situacionit ditore, për masën e kryerjes së shërbimit nga firma zbatuese, në kundërshtim me pikën 16.2 të nenit 1 të kontratës”.

-Në dosjen e supervizorit nuk ka kopje të situacioneve mujore, rregullore për certifikatat e siguracionit, mungojnë grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të fshirjes e larjes së rrugëve, për transportin e mbeturinave, larjen dhe dezinfektimin e kontejnerëve, për mirëmbajtjen e pikave gjatë ditës dhe grumbullimin e mbetjeve në kundërshtim me nenin 26 të kontratës.

4 A.K. me detyrë Kryeinspektor i IMTV, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shpronësimeve dhe

5. K.B. me detyrë specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të komisionit të shpronësimeve.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet për interes publik, si dhe për marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme”, dhe VKM nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që zhvlerësohen dhe

personave të tretë”, për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të cilët preken nga ndërtimi i objekteve infrastrukturore dhe konkretisht për realizimin e investimit për interes publik “Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës nr. 5, loti II dhe III Sarandë”, nga ku rezulton se subjekti Rustem Shehaj është paguar për shpronësimin e objekti Banese dhe Truall, me sipërfaqe prej 309 m² truall dhe 398.2 m² ndërtesë, me vlere totale 32.466.812 lekë.

-Për këtë praktikë është konstatuar se vlerësimi i pasurisë është kryer mbështetur në konfirmimin e ZVRPP mbi konfirmimin e çmimit për pasuritë të llojit apartament dhe jo ndërtesë. Në mungesë të konfirmimit për pasuritë e llojit ndërtesë, bashkia ka marrë për bazë referencën maksimale të shitjes të pasurive të llojit apartament në vlerën prej 82395 lekë/m², kur mund të merrte për bazë referencën prej 50780 lekë/m², që do të thotë se kosto e shpronësimi mund të ishte 24,526,740 lekë dhe jo 32,758,222 lekë ose më pak në vlerën prej 8,231,482 lekë, shumë e cila përbën mospërdorim me efektivitet të fondeve publike të vëna në dispozicion.

6. z. G.D. me funksion ish-P/Zyrës së Financës, aktualisht specialist në Zyrën e Ndhmës Ekonomike Njësia Administrative Ksamil.

-Për kryerjen e pagesave të punonjësve për diferencë page në vlerën **79,204 lekë**, pagesa këto të kryera pa asnjë dokumentacion ligjorë për të argumentuar arsyen e kryerjes së këtyre diferencave, veprime në kundërshtim me pika 35/b pika 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

D/3. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:

Për 6 ish punonjësit e mëposhtëm, masa disiplinore për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë Sarandë dhe ish-Komunën Ksamil, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

1. **B.A.** me detyrë ish Kryetar i Komunës Ksamil.
2. **B.A.** me detyrë ish Drejtor i Taksave Bashkia Sarandë, periudhën shtator 2015-dhjetor 2016.
3. **A.Ç.** me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave Vendore në ish Komunën Ksamil, periudhën 01.08.2013-26.10.2015.
4. **F.M.** me detyrë ish-P/Zyrës Urbanistike Komuna Ksamil.
5. **M.E.** me detyrë ish-Inspektor IMTV në Komunën Ksamil.
6. **E.Dh.** me detyrë ish-Inspektor i Taksave Bashkia Sarandë.

D/4. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe dalë në pension:

Për ish punonjësin **P.H.** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve në Bashkinë Sarandë, nuk mund të rekomandohet masë disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi i sipërpërmendur kanë dalë në pension.

E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.
2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

F. MASA ADMINISTRATIVE:

F/1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 53, 56, 63, etj., të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 9, 10, datë 24.02.2017 dhe nr. 29, 30, 33, datë 02.03.2017, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe nenin 15 germa (c, ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i **rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), të **13** punonjësve për **10** procedura prokurimi, si më poshtë:

1. **F.K.** me funksion Kryetare e Bashkisë Sarandë, në cilësinë e Titullarit të AK, për lidhjen e kontratave shtesë pa procedurë prokurimi.
2. **E.Gj.** me funksion Drejtor i Drejtorisë Juridike, në cilësinë e Kryetarit të KVO për **5** procedura prokurimi me objekt:
 - a- "Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Cukës", me fond limit në vlerën 124,905,956 lekë.
 - b- "EKO Kampus Saranda", me fond limit në vlerën 276,292,007 lekë.
 - c- "Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit", me fond limit 88,036,649 lekë.
 - d- "Investime për rikonstrukcione në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës", me fond limit 1,570,833 lekë
 - e- "Blerje kontejnerë për mbeturina urbane", me fond limit 4,000,000 lekë.
3. **P.H.** me funksion ish-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO për **5** procedura prokurimi me objekt:
 - a- "Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Cukës", me fond limit në vlerën 124,905,956 lekë.
 - b- "EKO Kampus Saranda", me fond limit në vlerën 276,292,007 lekë.
 - c- "Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit", me fond limit 88,036,649 lekë.
 - d- "Investime për rikonstrukcione në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës", me fond limit 1,570,833 lekë
 - e- "Blerje kontejnerë për mbeturina urbane", me fond limit 4,000,000 lekë.

- 4. T.S.** me funksion Drejtoreshë e Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e anëtarit të KVO për 5 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Cukës”*, me fond limit në vlerën 124,905,956 lekë.
 - b- *“EKO Kampus Saranda”*, me fond limit në vlerën 276,292,007 lekë.
 - c- *“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”*, me fond limit 88,036,649 lekë.
 - d- *“Investime për rikonstruksione në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës”*, me fond limit 1,570,833 lekë
 - e- *“Blerje kontejnerë për mbeturina urbane”*, me fond limit 4,000,000 lekë.
- 5. E.G.** me funksion juriste, në cilësinë e anëtarit të NJP për 2 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Rehabilitim i KU Ksamili i Poshtëm + 15KS -I(Metoq)”*, me fond limit 49,019,454.
 - b- *“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”*, me fond limit 88,036,649 lekë.
- 6. A.D.** me funksion specialiste pagash, në cilësinë e anëtarit të NJP për 2 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Rehabilitim i KU Ksamili i Poshtëm + 15KS -I(Metoq)”*, me fond limit 49,019,454.
 - b- *“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”*, me fond limit 88,036,649 lekë.
- 7. H.K.** me funksion Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit e Zhvillim Territorit, në cilësinë e anëtarit të NJP për 1 (një) procedurë prokurimi me objekt:
- a- *“Rehabilitim i KU Ksamili i Poshtëm + 15KS -I(Metoq)”*, me fond limit 49,019,454 lekë.
- 8. E.P.** me funksion specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të NJP për 1 (një) procedurë prokurimi me objekt:
- a- *“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”*, me fond limit 88,036,649 lekë.
- 9. A.B.** me funksion ish-Inspektor në IMTV, në cilësinë e kryetarit të KVO për 2 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Rikonstruksion Rruga nr. 17. Pjesa Komune – Degëzim rruga nr. 17/1 (faza e parë)”*, me fond limit në vlerën 3,333,331 lekë.
 - b. *“Rrethimi i varrezave Ksamil”*, me fond limit në vlerën 2,485,913 lekë.
- 10. F.M.** me funksion ish-Përgjegjës i Planifikim e Zhvillim Territorit, në cilësinë e anëtarit të KVO për 2 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Rikonstruksion Rruga nr. 17. Pjesa Komune – Degëzim rruga nr. 17/1 (faza e parë)”*, me fond limit në vlerën 3,333,331 lekë.
 - b. *“Rrethimi i varrezave Ksamil”*, me fond limit në vlerën 2,485,913 lekë.
- 11. B.Sh.** me funksion Spec/Ndihmës Ekonomike, në cilësinë e Kryetarit dhe anëtarit të KVO për 3 procedura prokurimi me objekt:
- a- *“Rikonstruksion Rruga nr. 17. Pjesa Komune – Degëzim rruga nr. 17/1 (faza e parë)”*, me fond limit në vlerën 3,333,331 lekë.
 - b- *“Rrethimi i varrezave Ksamil”*, me fond limit në vlerën 2,485,913 lekë.
 - c- *“Rikonstruksion i rrugës nr. 17 (nga Komuna deri te kryqëzimi i rrugës 17/1)”(vazhdimi faza e dyte asfaltimi)”*, me fond limit në vlerën 6,637,068 lekë.
- 12. A.B.** me funksion ish-Inspektor në IMTV, në cilësinë e anëtarit të KVO për 1 (një) procedurë prokurimi me objekt:

a-“Rikonstruksion i rrugës nr. 17 (nga Komuna deri te kryqëzimi i rrugës 17/1)”(vazhdimi faza e dyte asfaltimi)”, me fond limit në vlerën 6,637,068 lekë.

13. z. M.E. me funksion ish-Inspektor në IMTV, në cilësinë e anëtarit të KVO për **1** (një) procedurë prokurimi me objekt:

a-“Rikonstruksion i rrugës nr. 17 (nga Komuna deri te kryqëzimi i rrugës 17/1)”(vazhdimi faza e dyte asfaltimi)”, me fond limit në vlerën 6,637,068 lekë.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Në ngritjen e KVO, **Titullari i AK** nuk ka respektuar dispozitat e nenit 56- *Titullari i autoritetit Kontraktor ose zyrtari i autorizuar*, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke emëruar si anëtar znj. Teuta Stroka me funksion Drejtor Ekonomik, ku në zbatim të nenit 22, të ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të ndryshuar, pika (b);

-Nuk është siguruar një ndarje ndërmjet detyrave të zyrtarëve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave, në kundërshtim me nenin 56 dhe 57, të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Për vitin 2015-2016, u konstatua se disa kontrata shërbimesh (pastrimi dhe rojet private), nuk është zbatuar kriteri i lidhjes së kontratës shtesë deri në 20% të vlerës dhe kryerjen e procedurave të rregullt prokurimi për kontratat e reja, veprime këto në shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe pikës (d, dh) e nenit 36, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik”, konkretisht:

a-Likuidimin e shpenzimeve për pastrimin e qytetit të Sarandës.

Nga ana e Titullarit të AK, janë lidhur dy kontrata shtesë për vijimin e shërbimit të pastrimit të qytetit, veprime në kundërshtim me shkronjën (a,b) e pikës 5, të nenit 33, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe neni 7 pika 4, neni 34 pika 2, gerrat (e, ë), neni 36 pika 3, 5 dhe 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **veprim me efekt financiar negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 4,804,702 lekë**, konkretisht:

1. Kontrata nr. s'ka, datë 04.01.2016 me vlerë **3,480,269 lekë pa tvsh**, për një periudhë 78 ditore nga data 01.01.2016 deri me datë 12.03.2016.

2. Kontrata nr. 16/2, datë 24.05.2016 me vlerë **4,804,702 lekë pa tvsh**, për një periudhë 78 ditore nga data 13.03.2016 deri me datë 24.05.2016.

b-Likuidimin e shpenzimeve për pastrimin e qytetit të Ksamilit.

Me përfundimin e kontratës së pastrimit në qytetit të Ksamilit nr. 732, datë 10.06.2015, për vijimin e shërbimit Bashkia Sarandë ka procedurat me dy kontrata shtesa me subjektin, veprime në kundërshtim me shkronjën (a,b) e pikës 5, të nenit 33, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe neni 7 pika 4, neni 34 pika 2, gerrat (e, ë), neni 36 pika 3, 5 dhe 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **veprim me efekt financiar negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 1,675,738 lekë**, për kontratat:

1. Kontrata nr. s'ka, datë s'ka për një periudhë 72 ditore nga data 01.01.2016 deri me datë 12.03.2016 dhe vlerë kontrate prej **1,675,738 lekë**.

2. Kontrata nr. 16/2, datë s'ka ndërmjet për një periudhë 78 ditore nga data 13.03.2016 deri me datë 24.05.2016 dhe vlerë kontrate prej **1,675,738 lekë**.

c-Likuidimin e shpenzimeve për ruajtjen e objekteve të Bashkisë Sarandë dhe Studimit.

Nga dokumentacioni i bankës, u konstatua se për këtë shërbim është lidhur dhe një kontratë tjetër shtesë **nr. s'ka, datë 12.03.2016** ndërmjet Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga Kryetari

dhe subjektit për një periudhë 70 ditore nga data 12.03.2016 deri me datë 18.05.2016 dhe vlerë kontrate prej **599,655 lekë me tvsh**, kontrata këto të likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 233, datë s'ka për vlerën **599,655 lekë** me tvsh dhe urdhër shpenzimin nr. 369, datë s'ka për vlerën **599,655 lekë** me tvsh, veprime në shkëlqje të procedurës së prokurimit, pasi:

Bashkia Sarandë nuk ka nxjerrë urdhër prokurimi si dhe nuk janë hartuar regjistra shtesë të parashikimit të prokurimeve publike, veprime në kundërshtim me shkronjën (a,b) e pikës 5, të nenit 33, të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe neni 7 pika 4, neni 34 pika 2, gjerat (e, ë), neni 36 pika 3, 5 dhe 6, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me efekt financiar negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën **599,655 lekë**.

1. Në tenderin me objekt: "Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Cukës", me fond limit në vlerën 124,905,956 lekë, zhvilluar me datë 30.11.2015, në të cilën është shpallur fitues OE me vlerë kontrate prej 120,145,961 lekë.

-Operatori ekonomik i shpallur fitues me vlerë oferte **120,145,961 lekë**, nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen e subjektit (*dokumentet e tenderit*) dhe në sistemin e app.gov.al, konstatohet se dhe ky operator **nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST, për arsye se:**

a-Në lidhje me plotësimin e kërkesës se duhet të kenë të punësuar me kohe të plote dhe të përfshirë në liste pagese jo me pak se **30 punonjës** të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik të lëshuara nga Inspektorati Qendror Teknik (IQT), nga të cilët 10 të jenë elektrikiste ku 3 të jene minimumi me kategorinë IV, 5 manovratore, 3 hidraulike, 5 teknike ndërtimi dhe inxhinier përkatës të kërkuar në piken 4, OE, në verifikimin e dokumenteve, **rezulton se në listepagesat nuk figuron M.S.**

b-Janë kërkuar 3 hidraulike por në fakt janë **paraqitur vetëm 2**, janë kërkuar 5 teknike ndërtimi janë paraqitur 5, por në **listepagesat e shoqërisë nuk figuron tekniku T.S.**

c- Nga auditimi i përvojës së suksesshme në ekzekutimin e punimeve të ngjashme, OE ka paraqitur 3 kontrata. Në 3 kontratat e paraqitura, **nuk ka punime të ngjashme** për ndërtimin e pesetave 1x1m H-2.5 m, 1x1m H-3.0 m, 1x1m H-3.5 m, 1x1m H-4.0m, 1x1m H-4.5m dhe se në asnjë nga punët e ngjashme nuk ka zërin "Vendosje pompa zhytëse për ujera të zeza".

d- Nuk plotëson shtojcën nr. 9, pasi **nuk ka paraqitur makineri për montim dhe nivelim tubash**, dhe makineria e paraqitur është për ngjitje tuba betoni dhe jo plastike.

f- Nuk plotëson pikën 4-Stafi drejtues i shoqërisë teknike, pasi **inxhinieri i mjedisit nuk është pajisur certifikatë nga IQT-ja**, por ka vetëm një dëshmi kualifikimi:

g- Subjekti me datë 31.11.2015 ka deklaruar se makineritë e deklaruara në Shtojcën 9 nuk do të jene të angazhuara në kontrata të tjera gjatë periudhës së zbatimit të objektit.

Konstatohet se 3 mjetet e përcaktuara në shtojcën 9, konkretisht "Ekskavator çekiç hidraulik", janë të angazhuara në tenderin me objekt "Ndërtim dhe asfaltim i rrugës nr. Loti II dhe III", në proces ndërtimi ku sipas kontratës nr. 577rep/582kol, datë 05.05.2015 afati për përfundimin e punimeve është 24 muaj ose deri me datë 16.6.2017, fakt ky i cili është një deklaram i rremë dhe sipas DST duhet s'kualifikuar.

Në këto kushte KVO, **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, neni 2 "Parimet e përzgjedhjes", neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi", të ligjit 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

2. Në tenderin me objekt "EKO Kampus Saranda", me fond limit në vlerën 276,292,007 lekë, zhvilluar në vitin 2015, në të cilën është shpallur fitues BOE me vlerë kontrate prej 275,481,211 lekë.

-Bashkimi i operatorëve ekonomik i shpallur fitues me vlerë oferte prej **275,481,211 lekë**, **nuk i plotëson të gjitha kriteret DST** të vendosura nga AK, *për arsye se:*

a-Vërtetimi i OSHEE i shoqërisë “BE-IS” shpk me date 28.10.2015 është jashtë afatit kohor të kërkuar, **pasi objekti si afat për pranimin e dokumenteve datë 30.11.2015.**

b-Shoqëria ka paraqitur vërtetim për gjendjen financiare me një vlerë 1,021,899 lekë. Në bazë të kontratës për bashkim të përkohshëm të shoqërive me nr. 9475/Rep dhe nr. 4844/Kol, kjo shoqëri mere përsipër të kryej 59% të punimeve. Në DST kërkohet një certifikatë e gjendjes financiare nga një ose më shumë banka për gjendje likuiditetesh në vlerë jo më të vogël se **27,629,201** lekë pa TVSh (10 % të vlerës së objektit), të lëshuar jo më parë se 5 ditë nga dita e hapjes së ofertave). Kjo shoqëri duhet të kishte një gjendje financiare 16,301,228 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 914, date 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu VIII neni 74 pika 3, kriter ky i paplotësuar.

c-Në përvojën e suksesshme në ekzekutimin e punimeve të ngjashme, rezultoi se shoqëria ka paraqitur kontratë me objekt: “Rikualifikim urban i Qendrës së Kinostudios, Sheshit Kinostudio dhe Blloku 91” me vlerë kontratë 173,599,678 lekë me TVSh, “Shtese Kontrate Rikualifikimi urban i qendrës Kinostudio, sheshit Kinostudio e Bllokut 91” me vlerë 34,681,460 leke me TVSh dhe objektin “Lyerje Fasdash në Qytetin Sukth i Ri” me vlerë 4,590,410 lekë me TVSh, **por këto kontrata nuk janë shoqëruar me dokumente shtesë siç kërkohet në shtojcës 8 të DST**, ku për të dy objektet e para **nuk ka paraqitur** Certifikatën e marrjes në dorëzim, formulari i vlerësimit, ndërsa për objektin: “Lyerje Fasdash në Qytetin Sukth i Ri “ **mungon** Certifikata e marrjes në dorëzim.

d-Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia/Komuna për shlyerjen e Taksave Vendore për vitin 2015 sipas legjislacionit në fuqi për bashkim të OE, **është jashtë afatit 3 mujor.**

e-Është kërkuar të ketë në stafin e punonjësve të pasqyruar në listepagesat (për gjashtë muajt e fundit), të paktën **30** punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT. Nga auditimi rezultoi se janë paraqitur 30 punonjës nga të cilët 13 janë të pajisur me dëshmi kualifikimi nga IQT, **ndërsa për 17 punonjësit e tjerë janë paraqitur disa dëshmi që nuk janë nga IQT-ja.**

f-Në lidhje me kërkesat e pikës 8, sqarojmë se nga verifikimi në sistemin e app.gov.al, u konstatua se kapaciteti nuk është qa sa kërkohet në kërkesat e veçanta **2000 ton por 750.**

Në këto kushte KVO, **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

3. Në tenderin me objekt **“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”** me fond limit 88,036,649 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016, ka paraqitur ofertë të vetme BOE me vlerë të ofertës ekonomike **85,432,057 lekë pa TVSH**, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues nga KVO.

nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin app.bov.al, konstatohet se ky BOE nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në DST, *për arsye se:*

a- Operatori ekonomik me seli në Tiranë, nuk ka paraqitur vërtetim për pagesën e taksave vendore të Nipt sekondare në vende ku ka zhvilluar aktivitet edhe adresa të tjera në të cilat ka hapur. Për Bashkinë Kamzë dhe Vlorë vërtetimi nuk është brenda afatit të tre muajve të fundit, **pasi përmban respektivisht datën 24.07.2015 dhe 21.08.2014.**

b- Operatori ekonomik me seli në ish Komunën Farkë, bazuar në ekstraktin e paraqitur, ka zhvilluar aktivitet duke hapur NIPT sekondar edhe në ish Komunën Petrelë, ku vërtetimi i fundit për shlyerjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në mban datën 30.03.2015. Meqenëse ish-Komuna është shkrië në datën 30.06.2015, të drejtat dhe detyrimet e saj janë transferuar në Bashkinë Tiranë dhe vërtetimi duhej të merrej prej kësaj të fundit brenda afatit kohor të tre muajve të fundit.

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 2, të kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit të DST dhe KVO **nuk duhet të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues.**

4. Në tenderin me objekt: “Blerje kontejnerë për mbeturina urbane” me fond limit **4,000,000 lekë** zhvilluar në vitin 2016, kanë marrë pjesë dy OE ku është kualifikuar OE me ofertë më të lartë për vlerën **3,949,150 lekë.**

-Në auditimin e dokumentacionit të OE të kualifikuar [REDAKTUAR], konstatohet se ky operator **nuk i plotëson të gjitha kërkesat e DST, për arsye se:**

a-Certifikata ISO është në gjuhën angleze e pa përkthyer në gjuhën shqipe dhe e pa noterizuar, në kundërshtim me DST dhe rregullat e prokurimit publik.

b-Në dy kontratat e ngjashme, me objekt “Blerje Kazanë metalik” dhe “Kosha mbeturinash”, mungojnë formularët e vlerësimit.

Në këto kushte KVO, **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

5. Në tenderin me objekt “Investime për rikonstruksione në ambientet e Shtëpisë së Fëmijës” me fond limit 1,570,833 lekë zhvilluar në vitin 2016, është shpallur fitues OE [REDAKTUAR] shpk me vlerë të ofertës **1,318,830 lekë**, duke s’kualifikuar operatori ekonomik [REDAKTUAR] shpk me vlerë të ofertës **892,550 lekë**, për arsye se nuk plotëson kriterin e përvojave të mëparshme të ngjashme.

Në auditimin e dokumentacionit të sistemin e app.gov.al, rezulton se pretendimi i ngritur nga KVO për s’kualifikimin e OE **.nuk qëndron**, pasi nga OE është paraqitur kontratë për punë të ngjashme me objekt “Rikonstruksion i shkollës Janjar, Komuna Markatë” me vlerë **10,734,121 lekë**, realizuar brenda tre viteve të fundit, ku paraqiten dhe zëra pune të ngjashëm me ato të kontratës që prokurohet (si bërje dyer, dritare).

Nga OE [REDAKTUAR] është paraqitur amendamentin nr. 1, datë 04.04.2013, ku në nenin 1 citohet se “Afati kohor për përfundimin e kontratës shtyhet me 205 ditë”. Gjithashtu OE ka paraqitur procesverbalin e përfundimit të punimeve, akt-kolaudimin dhe situacionin nr. 4 përfundimtar të punimeve të cilët mbajnë datën 22.10.2013.

Për këto arsye, KVO duhet vlerësonte ofertat ekonomike të paraqitura nga OE pjesëmarrës në tender dhe në kushtet kur subjekti i s’kualifikuar OE [REDAKTUAR] **nuk qëndrojnë**, duhet të shpallte fitues OE me ofertë me të leverdishme që në rastin konkret është OE “TEA-D” me vlerë të ofertës 892,550 lekë, duke shkaktuar **dëm ekonomik në vlerën 426,280 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pikën 5 të nenit 46 “Kualifikim i ofertues” dhe nenit 53 “Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

6- Në tenderin me objekt “**Rehabilitim i KU Ksamili i Poshtëm + 15KS -I(Metoq)**”, me fond limit 49,019,454 lekë pa TVSH, zhvilluar në vitin 2016. Në rubrikën kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, **nga NJP** janë vendosur kriteret në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, se operatorët ekonomik duhet:

a- Të paraqes vërtetim zyra e financës dhe taksave të Bashkisë Sarandë se nuk është debitor në këtë institucion, **kërkesë e pabazuar ligjrisht**, pasi në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar që OE të paraqesë vërtetim se ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në të gjitha vendet ku ka zhvilluar aktivitetet, pra nuk është nevojshme të kërkohet më vete për Bashkinë Sarandë;

b- Të paraqesin kontrata të ngjashme me punime të së njëjtës natyrë, veprim në kundërshtim me pikën 6 e nenit 26, të VKM 914 datë 29.2.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, i ndryshuar, ku citohet se për të provuar përvojën e mëparshme autoriteti Kontraktor kërkon **punë të ngjashme (dhe jo të së njëjtës natyrë)**;

c- Të paraqesin formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore, shëndetësore e TAP dhe urdhër xhirimet, **kërkesë e panevojshme**, pasi në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar që “dokument të lëshuar nga administrata tatimore që vërteton se subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore”, **për këtë arsye të gjitha dokumentet e tjera janë të panevojshme**;

d- Të vërtetojë se ka në pronësi ose me qira fabrikë betoni, ose kontratë furnizimi me një të tillë, **por në preventiv nuk ka zëra punimesh që të lidhen me nevojën e një kërkesë të tillë** (si shtrim me beton etj.);

e-Të kenë **licencën NP-4A** (e cila është për rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista), si dhe **licencën NP-6A** (e cila është për diga dhe tunele hidroteknike), ndërkohë që në preventiv nuk ka asnjë zë pune që të përfshihet në licencën NP-4A dhe NP-6A, **kriter ky i paargumentuar**, në kundërshtim me pikën 2 e nenit 30, të VKM nr. 914, datë 29.2.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

f- Të ketë numrin mesatar të punonjësve jo më pak se 50, **kërkesë për të cilën nuk është dhënë asnjë argumentim**.

Kriteret e vendosura nga NJP janë diskriminuese, pasi nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe konkurrencën ndërmjet tyre, të paargumentuara, nuk lidhen me natyrën dhe objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 15, pika 26/5.

7-Në tenderin me objekt “Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”, me fond limit 88,036,649 lekë pa TVSH zhvilluar në vitin 2016.

Në rubrikën kriteret e veçanta të kualifikimit të DST, nga NJP janë vendosur kritere në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, se operatorët ekonomik duhet:

a- Të paraqesin licencë për prodhim ose tregtimi i farave ose fidanëve, lëshuar nga QKL, kriter i paargumentuar dhe i palidhur me objektin e kontratës;

b- Të paraqes certifikatë fitosanitare dhe origjine për pemët, kriter i palidhur me objektin e kontratës për fazën në të cilin kërkohet, pasi kjo është një certifikatë shoqërore për pemët që do të mbjell operatori nëse do të shpallet fitues dhe, kontrollohet në momentin e dorëzimit të pemëve jo në fillim të procesit të prokurimit;

c- Të paraqesin certifikatë ISO 9001:2008 për prodhim drurë dekorativ, kriter i palidhur me objektin e kontratës, pasi kjo është një certifikatë që ka të bëjë me sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe jo për prodhimin e drurëve dekorativ;

d- Të ketë numrin mesatar të punonjësve jo më pak se 90 (nëntëdhjetë), për periudhën Janar 2015 - Mars 2016, të ketë 11 kamion vetëshkarkues me kontratë ose me qira, 7 prej të cilëve me kapacitet mbi 15 ton dhe 4 me kapacitet 1.4-2 tonë, kritere këto të paargumentuara;

e- Të paraqesin dokument se ka fabrikë betoni në pronësi ose me qira, kriter i paargumentuar në lidhje me volumin e punimeve të kontratës, diskriminues, pasi nuk është e nevojshme që operatori të ketë në pronësi apo me qira fabrikë betoni, operatori fitues mund ta sigurojë betonin lehtësisht në treg;

f- Të jetë i pajisur nga Ministria e Kulturës me licencë për restaurimin e monumenteve të kulturës kategoria “C”, kriter i paargumentuar, pasi nuk ka asnjë dokument në dosjen e prokurimit, që të vërtetojë se përpara fillimit të punimeve ka objekte që përbëjnë monumente kulture.

Kriteret e vendosura nga NJP janë diskriminuese, pasi nuk nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe konkurrencën ndërmjet tyre, të paargumentuara, nuk lidhen me natyrën dhe objektin e kontratës, në kundërshtim me nenin 1, 2, 20, 23 dhe pikën 1 dhe 3 të nenit 46, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe VKM nr. 914, datë

29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” nenin 15, pika 26/5 (*Trajtuar në procesverbalit nr. 30, datë 02.03.2017 dhe faqet 121-188, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8- Në tenderin me objekt **“Rikonstrukcion Rruga Nr. 17. Pjesa Komune – Degëzim rruga Nr. 17/1 (faza e parë)”**, me fond limit në vlerën 3,333,331 lekë, zhvilluar me datë 17.5.2014, në të cilën është shpallur fitues BOE me vlerë kontrate prej **2,2525,500 lekë**.

Në auditimin e dokumentacionit të paraqitur në dosjen e subjektit të shpallur fitues, konstatohet se ky operator nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe të miratuara nga AK dhe të hartuara nga NJHDT, për arsye se: BOE nuk plotëson kapacitetin teknik (pika 1.3.2), pasi në stafin për ekzekutimin e kësaj kontrate inxhinieri hidroteknik ing. Mihal Papuci me kontrate pune të rregullt datë 16.07.2008 (pa afat) dhe me page 100,000 lekë në muaj në listepagesat e shoqërisë rezultojnë të paguhet me 30,000 lekë në muaj.

Në këto kushte KVO, **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

9. Në tenderin me objekt **“Rrethimi i varrezave Ksamil”**, me fond limit në vlerën 2,485,913 lekë, zhvilluar me datë 17.6.2014, në të cilën është shpallur fitues OE me vlerë kontrate prej **1,777,778 lekë**.

Në auditimin e dokumenteve të OE të shpallur fitues me vlerë oferte **1,777,778 lekë**, rezultojnë se ky OE nuk plotëson kapacitetin teknik, pasi drejtuesi teknik dhe specialist të nivelit të lartë, me kontratë të rregullt, pagesa sipas kontratës nuk është njëjtë me pagën e deklaruar në listepagesat e sigurimeve shoqërore, deklarim i rremë. Në DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kusht për s’kualifikim dhe në këtë rast të gjitha kontratat e me drejtuesit teknik të sipër cituar janë të pasakta dhe të rreme, në kundërshtim me nenin 47, të ligjit të LPP.

Në këto kushte KVO, **nuk duhej të kualifikonte asnjë nga OE**, pasi nuk plotëson kriteret e kualifikimit në DST të miratuara nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit dhe të vijonte me procedurë të tjetër prokurimi, nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

10. Në tenderin me objekt **“Rikonstrukcion i rrugës nr. 17 (nga Komuna deri te kryqëzimi i rrugës 17/1)”(vazhdimi faza e dytë asfaltimi)”**, me fond limit në vlerën 6,637,068 lekë, zhvilluar me datë 20.4.2015, në të cilën është shpallur fitues BOE me vlerë kontrate prej **5,534,888 lekë**.

Në auditimit të dokumentacionit të BOE të shpallur fitues, konstatohet se ky BOE nuk i plotëson të gjitha kërkesat e miratuara në DST nga AK dhe NJHDT, *për arsye se:*

a-Në DST kapaciteti teknik (pika 2.3.3) Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 7) është kërkuar Autobot/uji. Shoqëria “ILIRIA/D “shpk ka paraqitur mjetin Autobot Uji me targa SR6411B, sipas kontratës së qirasë me datë 12.06.2014 me afat 3 vjeçar, ku certifikata e kontrollit teknik ka mbaruar me datë 16.12.2014, ndërsa data e zhvillimit të tenderit është data 20.04.2015, **pra dokumentacioni nuk është i saktë**. Gjithashtu ky mjet në asnjë dokument të tij qoftë dhe me foto nuk tregon se është autobot, por është kamion me peshë 7.8 deri 18 kg, **gjë cila tregon se këtë kriter nuk e plotëson**.

b-Vërtetimi i lëshuar për likuidimin e taksave vendore për vitin 2014, për shoqërinë “ARTI” shpk mban datën 10.07.2014 i Komunës Lukove, me datë 29.04.2014 me Komune Finiq dhe Bashkia Sarandë, por që nuk ka datë se kur është lëshuar. Gjithashtu këto vërtetime janë jashtë

afatit kohor (tre mujor) te kërkuar pasi objekti si afat për pranimin e dokumenteve është data 20.04.2015.

c-Nuk plotëson kapacitetin teknik (pika 1.3.2), pasi në stafin për ekzekutimin e kësaj kontrate inxhinieri hidroteknik ing. Mihal Papuci me kontrate pune te rregullt datë 16.07.2008 (pa afat) dhe me page 100,000 lekë/muaj ne listepagesat e shoqërisë rezulton te paguhet me 30,000 lekë/muaj. Ne DST është shprehur qartë rastet e dokumenteve te rreme e te pasakta, konsiderohen si kusht për s'kualifikim dhe ne këtë rast te gjitha kontratat me drejtuesit teknik te sipërcituar janë te pasakta dhe te rreme konsiderohen kushte s'kualifikimin.

Në këto kushte anëtarët e KVO **nuk duhej të kualifikonin BOE**, pasi dhe ky BOE nuk plotëson kriteret e kualifikimit të miratuara në DST nga vetë AK, por duhej të anulonte procedurën e prokurimit, veprime në kundërshtim me nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

F/2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit, Bashkia Sarandë:

Bashkia Sarandë të marrë masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, Ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, Kreu III neni 29 dhe Kreu IV neni e 52, **t'i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes Territorit Bashkia Sarandë**, të vendosë masë administrative me gjobë si më poshtë:

-Për F.K. në masën 500,000 lekë, për shkeljet e konstatuara në 2 investime publike gjatë ushtrimit të funksionit të saj si Titullar i AK Bashkia Sarandë. Konkretisht u konstatua nisja e procedurave të prokurimit, lidhja e kontratave përkatëse me sipërmarrësit e punimeve si dhe likuidimin për punë të pakryera (në momentin e likuidimit) në vlerën **64,397,160 lekë me tvsh kur ende nuk ka qenë disponuar leja përkatëse e ndërtimit në 2 investime publike:**

1. Në objektin “Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”;
2. Në objektin “Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza, zona nga Hotel Butrinti deri tek Kanali i Çukës”;

Këto veprime këto bien në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Seksioni III, neni 39, pikat 1, 2 dhe pika 3.

-Për K.K. në masën 200,000 lekë, në cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve për shkeljet e konstatuara në **4** investime publike, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **50,518,088 lekë pa tvsh** në objektet:

1. “Ndërtim asfaltim rr. R .5, Loti II dhe III”, vlera **31,014,500 lekë pa tvsh;**
2. “Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Çukës”, vlera **18,885,088 lekë pa tvsh;**
3. “Konturimi dhe shtrimi i rrugëve të brendshme të fshatit Gjashte Ofiçina e Naftës, Metoq”, vlera **618,500 lekë pa tvsh.**

Për këto 3 objekte janë firmosur situacione pjesorë dhe/apo përfundimtare me punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer, ose jo në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratat e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe OE, me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3, pika 8.1 dhe 8.3 si dhe

kontratat e lidhur mes Titullarit (apo ish – Titullarit) të AK dhe ing. Kristaq Kali për shërbimin e për mbikëqyrjes apo atë të kolaudimit të punimeve.

-Për A.T. në masën 200,000 lekë, për shkeljen e konstatuar në 1(një) investim publik, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **27,001,518 lekë pa tvsh, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve vlera 27,001,518 lekë pa tvsh** në objektin: *“Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”*, vlera **27,001,518 lekë pa tvsh**;
Për këtë objekt janë firmosur situacione pjesorë dhe përfundimtarë me punime të pakryera në fakt apo të pa ndryshuara sipas zërit të kryer, ose jo në përputhje me analizën e parashikuar në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe OE, me VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3, pika 8.1 dhe 8.3 si dhe kontratën e lidhur mes Titullarit të AK dhe ing. A.T. për shërbimin e për mbikëqyrjes së punimeve.

G. KALLËZIM PENAL:

I. Bazuar në kualifikimin e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 *“Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”*, Seksioni III, neni 39; Udhëzimin nr. 2 datë 06.0.2012 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, Kreu III Procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike , pika 147, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, Kreu II, neni 8, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 *“Për prokurimin publik”*, Kreu I, neni 1, pika 2, germa b, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, si dhe kontratave të sipërmarrjes nr. 21 dhe 22, datë 23.12.2015, për:

1. F.K. me funksion Kryetare e Bashkisë Sarandë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë.

2. z. P.H. në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për zbatimin e investimeve:

- *“Ndërtim asfaltim rr. R .5, Loti II dhe III”*

- *“Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”*

- *“Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Çukës”*

- *“Konturimi dhe shtrimi i rrugëve të brendshme të fshatit Gjashte Ofiçina e Naftës, Metoq”*

II. Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me nenin 2, 24, 53 dhe nenin 55 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, për:

3. E.G.J. me funksion Drejtor Juridik, në cilësinë e Kryetarit të KVO

4. P.H. me funksion ish-Drejtor Shërbimesh, në cilësinë e anëtarit të KVO

5. T.S. me funksion Drejtoreshë Ekonomike, në cilësinë e anëtarit të KVO, për 3 procedura prokurimi dhe konkretisht:

- *“Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Çukës”*
- *“EKO Kampus Saranda”*
- *“Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit”*

III. Bazuar në kualifikimin e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”*, Kreu I, pika 7, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3; Udhëzimi nr. 1, datë 16.06.2011 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, pika 4, Kreu I, pika 2 dhe 15; ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, Kreu I, neni 5; Vendimi Nr. 514, datë 15.08.2007 *“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9, si dhe kontratave të sipërmarrjes nr. 21 dhe 22, datë 23.12.2015, për:

- 7. K.K.** nën cilësinë e mbikëqyrësit/kolaudatorit të punimeve, për veprime në kundërshtim
- *“Ndërtim asfaltim rr. R .5, Loti II dhe III”*
 - *“Përmirësimi i rrjetit të ujerave të zeza Hotel "Butrinti" deri te Kanali i Çukës”*
 - *“Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”*
 - *“Konturimi dhe shtrimi i rrugëve të brendshme të fshatit Gjashtë Ofiçina e Naftës, Metoq”*

8. A.T. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për investimin, *“Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit”*.

L. INDICIE PËR NDJEKJE PENAL:

I. Në zbatim të nenit 15 germa “gj.; të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe nenit 248 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 *“Kodit Procedurës Penale”*, i ndryshuar, dërgojmë Indicie për Ndjekje Penale, për veprime në kundërshtim me VKM nr. 321, datë 28.05.2014 *“Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”*, i ndryshuar si dhe VKM 369, datë 18.05.2016 *“Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”* për:

1. J.M. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe në cilësinë e Drejtorit të Taksave Vendore mbi lidhjen e zbatimit të kontratave të qirasë të zonës bregdetare (plazhet)

II. Në zbatim të nenit 15 germa “gj.; të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”* dhe nenit 248 të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 *“Kodit Procedurës Penale”*, i ndryshuar, dërgojmë për vlerësim dhe veprim të mëtejshëm procedural Raportin Përfundimtar të Auditimit (pjesën takuese) lidhur me procedurën e legalizimit të objektit ndërtesë e truall në posedim të qytetarit R.SH, pasuria 11/168, e ndodhur në lagjen nr. 3, zona kadastrale 8642, me sipërfaqe prej 309 m² truall dhe 398.2 m² ndërtesë, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ